



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar  
në “Farmaci”**

**Institucioni i Arsimit të Lartë  
“Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. PhD. Driton Vllasalliu

2. PhD. Entela Celiku

Mars/2020

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” i ofruar nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë (FM), Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT) është programi i parë dhe i vetëm në fushën farmaceutike që ofrohet prej rreth 60 vitesh në arsimin e lartë publik në vendin tonë.

Programi i studimit është hapur për herë të parë në vitin akademik 1960-1961 me dekret të Kuvendit Popullor Nr. 241, dt. 02.06.1960. Sipas këtij Dekreti u vendos hapja e Studimeve Universitare për Farmaci pranë Fakultetit të Mjekësisë.

Me riorganizimin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës dhe themelimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, FM si pjesë e UMT.

UMT është vlerësuar dhe akredituar institucionalisht në vitin 2018 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare.

Programi i studimit është ofruar pa ndërprerje nga Departamenti i Farmacisë i cili është përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e tij. Ky program, për shkak të natyrës së dyfishtë të disiplinave përbërëse, të cilat i përkasin jo vetëm fushës së shkencave natyrore por edhe të shkencave mjekësore, fillimisht është ofruar nga Departamenti i Farmacisë si pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT dhe së fundmi si pjesë e Fakultetit të Mjekësisë (2005 - vazhdim).

Departamenti i Farmacisë ofron gjithashtu edhe një program të ciklit të tretë, “Doktoratë në Shkencat farmaceutike”, e cila bashkë me programet e tjera analoge të ofruara nga UMT aktualisht janë të pezulluara si pasojë e tranzicionit ligjor në arsimin shqiptar.

Me miratimin e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 (LAL 80/2015) dhe kuadrit ligjor në fuqi, departamenti ka kryer përshtatjet e programit të studimit si dhe të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative në përputhje me aktet ligjore në fuqi.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm është bazuar në të dhënat, evidencat dhe informacionet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, njësia kryesore përkatëse dhe administrative të realizuara me mjete të ndryshme të komunikimit si intervista dhe diskutime gjatë vizitës në IAL, sikurse edhe dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e ASCAL. Evidencat dhe RVB, shërbyen si bazë për përgatitjen e raportit të jashtëm për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” dhe gjithashtu si evidenca mbështetëse.

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit, Mësimdhënia, Mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat, Burimet, Studentët dhe mbështetja e tyre dhe Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përbushen,
- Standardet përbushen pjesërisht,
- Standardet përbushen kryesisht
- Standardet përbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është administruar dhe koordinuar nga ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Driton Vllasaliu dhe PhD Entela Hodaj, ekspertë vlerësimi dhe nga znj. Emisa Isufaj, koordinatorë teknike, e cila i ka asistuar gjatë procesit të dhe znj, Xhiliola Bixheku e cila i ka asistuar gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të jashtëm, përfaqësuese të ASCAL.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza: Vlerësimi i brendshëm ku institucioni ka dorëzuar Raportin e vlerësimit të brendshëm së bashku me dokumentacionin mbështetës (DVB).

Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, u zhvilluan vizitat në datat 9 dhe 10 Janar 2020 sipas një agjende të përcaktuar nga GVJ në bashkëpunim me ASCAL. Gjatë vizitës në vend janë takuar aktorët kryesor të këtij institucioni dhe studentët. Këto takime kanë ndihmuar në hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm nga GVJ.

GVJ konkludon në rekomandimet përkatëse bazuar në plotësimin e sandarteve në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”.

Më datë 03.03.2020, me shkresë zyrtare Nr. 2/4 Prot., datë 03.03.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 04.03.2020, përmes sistemit AMS, Institucioni shprehet se nuk ka komente rreth Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

IAL shprehet se nuk ka komente në lidhje me draft-Raportin, ky i fundit kthehet në raport final.




## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar/Shkencave në “Farmaci”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë ofron programin e integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” prej 60 vitesh, duke kontribuar në formimin e profesionistëve të fushës farmaceutike në përputhje me interesat kombëtare dhe institucionet politikëbërëse në fushën e shëndetësisë [Evd.4,61,62].
<b>Kriteri 2.</b> Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Departamenti i Farmacisë është njësi përgjegjëse e ofrimit të programit të studimit me mbështetjen dhe të njëjve të tjera përbërëse të Fakultetit të Mjekësisë, me qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare [Evd.3,58,66].
<b>Kriteri 3.</b> Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin e UMT, strategjinë dhe misionin e tij. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë ekspertë cilësorë të fushës së farmaceutikës [Evd.1, 2, 4, 66].
<b>Kriteri 4.</b> Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi ka qenë për shumë vite promotori i vetëm në tregun e punës në fushën farmaceutike si në drejtimin e rrjetit të hapur farmaceutik, në rrjetin spitalor, në linjën e prodhimit farmaceutik si dhe në organet dhe autoritetet drejtuese e administrative publike të këtij sektori. Duke qenë se profesionistët e diplomuar pas licensimit mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si subjekte farmaceutike private, rritja e numrit të tyre ka sjellë rritje të vendeve të punësimit si dhe rritje të të ardhurave duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të qyteteve përkatëse, e për pasojë edhe në nivel kombëtar. Gjithashtu, rritja e numrit të profesionistëve të diplomuar në fushën farmaceutike me një vizion ndërkombëtar dhe koherent me zhvillimet në këtë fushë, ka tërhequr një sërë investitorësh farmaceutikë ndërkombëtarë të njohur, duke ndikuar jo vetëm në nivelin e punësimit por edhe në garantimin e cilësisë së ofrimit të barnave dhe importit të tyre. [Evd.145,71]
<b>Kriteri 5.</b> Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;	Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin e UMT dhe ka për qëllim jo vetëm të ofrojë njohuri dhe aftësi profesionale, por të përgatisë studentët dhe të diplomuarit me aftësi dhe kompetenca të thelluara që ndihmojnë në vijimin e studimeve të thelluara edhe në ciklin e tretë [Evd.61]. Konkretisht, në vijim të programit të




	studimit të integruar 5 vjeçar, departamenti ofron edhe programin e ciklit të tretë “Dokoratë në Shkenca Farmaceutike” (aktualisht pezulluar nga MASR), sipas RVB dhe evidencave departamenti ka prezantuar projekt-propozimin për një program të ciklit të tretë “Specializim afatgjatë në Farmacinë Spitalore” duke dashur që të ofrojë për rrjetin spitalor profesionistë të kualifikuar në profilin e farmacisë spitalore në përputhje me modelet analoge evropiane.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit vazhdimisht ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, statutin e UMT si dhe me aktet rregullatore ku janë të parashikuara struktura, zhvillimi dhe organizimi i programeve të studimit. UMT është i vetmi institucion publik që ofron numrin më të lartë të programeve të studimit në fushën mjekësore, në përputhje edhe me emërtimin e tij. Si një institucion me profil mjekësor, emërtimi i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është në përputhje të plotë edhe me linjat dhe drejtimet e zhvillimit institucional.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Institucioni, si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore në fushën e arsimit të lartë në vitet e fundit, edhe në Statutin e ri (miratuar në shtator 2019) ka për qëllim zhvillimin e prioriteteve akademike të programit të studimit. Sipas RVB dhe evidencave 5 janë ngritur grupet e punës për harmonizimin e akteve rregullatore me statutin e ri [Evd.5].
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Emërtimi i këtij programi studimi diplomë e Integruar, “Master i Shkencave” në “Farmaci” është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (KSHK), [Evd.49] dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit farmaceutik.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me aktet rregullatore të institucionit, prioritetet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe fakultetit, dhe për më tepër ato janë në të njëjtën linjë dhe zbatojnë strategjinë kombëtare të zhvillimit të vendit në fushën e shëndetësisë [Evd.4,61,62]. Edhe plani strategjik i programit të studimit në vijë të parë ka përputhjen me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare. Prej vitesh dhe në vazhdim ky program studimi është promotor dhe mbështet të gjitha iniciativat legjislative, kërkimore dhe akademike brenda dhe jashtë vendit duke qenë pjesë e komisioneve në nivele këshilluese/ekspertize por edhe në nivele

	vendimmarrëse [Evd.132,61].		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi I.3**  
**Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Programi i integruar i studimit i ofruar nga Departamenti i Farmacisë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve me njohuri të thelluara shkencore, aftësi dhe kompetenca profesionale në përputhje me profilin e programit dhe në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen. [Evd.61-69].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Për shumë vite, “Master i Shkencave” në “Farmaci”, ka qenë programi i vetëm i ofruar në nivel kombëtar në këtë fushë deri në vitin 2005. Bazuar në studimin e tregut të punës të bërë nga të dhënat zyrtare të ofruara nga bashkëpunimi me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Urdhrin e Farmacistëve për farmacistët e diplomuar, licensuar apo drejtues teknikë</li> <li>- QSHA për diplomantët që fitojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit</li> <li>- Të dhënat e Alumni nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta</li> <li>- Edukimin në vazhdim</li> </ul> Vihet re se nevojat për farmacistë në vitet e fundit kanë qenë të larta në rajone të ndryshme të vendit [Evd.71,96,56] duke u reflektuar edhe në numrin e madh të aplikantëve. Ndërkohë, nevojat e tregut të punës plotësohen pas vitit 2008 edhe nga ofruesit e arsimit jo publik si mundësi alternative e edukimit në fushën e farmaceutikës.  Nga ana tjetër, institucioni synon cilësinë dhe përgatitjen profesionale të farmacistëve duke propozuar në mënyrë konstante dhe racionale numrin e kuotave të pranimit, bazuar në kapacitetet optimale infrastrukturore dhe akademike, pavarësisht numrit të lartë të aplikimeve në këtë program studimi [Evd.44]. Në strategjinë e programit të studimit theksohet synimi drejt rritjes së kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore të mëtijshme në mënyrë që të ofrohen edhe më shumë kuota pranimi, ku po punohet prej disa vitesh për zgjerimin e stafit akademik dhe infrastrukturës në nivel njësie kryesore.
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë	Programi ka të përcaktuar qartë objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen, kriteret e pranimit, metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit, vlerësimin e njohurive, dijeve, aftësive dhe kompetencave të përcaktuara edhe në syllabuset e lëndëve/moduleve përbërëse të

përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	programit të studimit. [Evd.61-66]			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	GVJ konstaton se programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare në disa rajone të BE. Ndërsa, programi Master i Shkencave në Farmaci në rajone tjera (SHBA, Kanada, Australi dhe Angli) ka fokus me të theksuar në farmaci klinike. Megjithatë, përafrimi me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucionet e rajonit dhe BE-se është tërësisht i kuptueshëm/pranueshëm.  Në nivel kombëtar, përmbajtja e programit është e ngjashme me ofruesit e tjerë, pasi ai ka shërbyer si udhërrëfyes për hartimin e kurrikulave të programeve përkatëse në institucionet jopublike të arsimit të lartë. [Evd.34,36,70,101,151].			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.	GVJ konstaton se programi i studimit hartohet në përputhje me direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara dhe me sistemin e Bolonjës. [Evd.34,36,70,101,151].			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Në programin e integruar të studimit, rreth 24 % (774,5 lab / 3233 total) e orëve mësimore janë laboratorike dhe 14% (450 orë) e zënë orët për aftësimin profesional të studentëve [Evd.65]. Praktika profesionale është pjesë e programit dhe është hartuar në përputhje me direktivat europiane dhe me bazën ligjore për profesionet e rregulluara në vend, [Evd.143] e cila organizohet dhe rregullohet me rregullore specifike. [Evd.64,158].			
<b>Kriteri 7.</b> Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.	Si program i integruar i listuar në programet e studimit të Maturës Shtetërore që zgjidhet nga maturantët, programi ofrohet në gjuhën shqipe. Në periudhat kur parashikohen vizita të studentëve të huaj, veçanërisht në vitet e fundit, procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera realizohen në gjuhën angleze. Aktiviteti i kërkimit shkencor ka ecur më shpejt drejt ndërkombëtarizimit nëpërmjet projekteve [Evd.30] duke pasur edhe studentë të huaj në këtë proces. [Evd.33,34]			
<b>Kriteri 8.</b> Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Informacioni i programit të studimit arkivohet në arkivin e UMT në përputhje me rregulloren përkatëse [Evd.131]. Prej vitit 2016 – 2017, gjatë procesit të akreditimit institucional, institucioni në tërësi dhe FM arkivojnë dokumentacionin kryesor edhe në gjuhën angleze si p.sh. aktet rregullatore, programi i studimit, plani mësimor, syllabusët e lëndëve, CV e personelit akademik, dokumentacioni i aktiviteteve dhe bashkëpunimeve etj. [Evd.liste dok në anglisht]. Ky informacion ruhet në formë elektronike si edhe në formë “hardcopy”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



standardit				X
------------	--	--	--	---

<b>Standardi I.4</b>				
<b>Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë	<p>Institucioni në funksion të programit të studimit ofron burimet dhe kapacitetet akademike me personalitete të njohur të fushës farmaceutike. [Evd.101]</p> <p>Stafi akademik aktual është me grada/tituj, ku një pjesë e tyre janë të fituara në vendet e BE-së [Evd.59,75,76], të cilët karakterizohen nga një numër i lartë publikimesh në fushën farmaceutike, artikuj e botimesh në revista me Faktor impakti (sipas JCR) / të indeksuar në Scopus, si dhe referime dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare të fushës farmaceutike. [Evd.107]</p> <p>Numri, gradat dhe titujt akademikë plotësojnë optimalisht raportet dhe koeficientët të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi. Konkretisht, stafi akademik i Departamentit që ofron programin mbulon mbi 70 % të ngarkesës mësimore. [Evd.78] Në funksion të realizimit të programit të studimit, institucioni ka në dispozicion edhe stafin ndihmës akademik dhe personel administrativ në nivel njësie kryesore. Gjithashtu, njëjësia bazë çdo vit akademik fton lektorë me kohë të pjesshme të kategorisë Profesor në fushën farmaceutike [Evd.77,78,79]. Konkretisht departamenti perbehet nga 11 personel akademik me kohë të plotë, 5 personel ndihmës akademike me kohë të plotë. Në funksion të realizimit të ngarkesës mësimore të programit të studimit përveç anëtarëve të departamentit janë dhe 30 personel me kohë të plotë pjesë e UMT si dhe 34 personel me kohë të pjesshme.</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Në përputhje me direktivat evropiane, fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit janë ndërtuar dhe zhvilluar në përputhje me fushën akademike të UMT, njësisë kryesore dhe njësisë bazë të cilat e kanë të specifikuar jo vetëm në strategjinë e tyre të zhvillimit, në rregulloret përkatëse në linjat e tyre të kërkimit por dhe në emërtimin e tyre (UMT, FM, Departamenti i Farmacisë). [Evd.61-66].</p>			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>GVJ konstanton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	



standardit				X
------------	--	--	--	---

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UMT si institucion arsimor ka misionin kryesor formimin e profesionistëve të fushave së mjekësisë si dhe përgjegjësinë e ofrimit të një edukimi cilësor dhe me standartete duke ndarë dhe organizuar punën në të gjitha hallkat e strukturës akademike dhe administrative. [Evd. 36,103, 114]. Institucioni ka një historik shumëvjeçar në ofrimin e programeve të studimit, tashmë ka një traditë të organizimit dhe ndarjes së detyrave akademike dhe administrative. GVJ konstanton se kriteri permbushet plotesisht.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Institucioni në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit realizon një numër të gjerë bashkëpunimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si me institucione publike ashtu dhe jopublike. [Evd.26].
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UMT ka realizuar marrëveshje me IAL të huaja të cilat ofrojnë programin e studimit Master i Shkencave në Farmaci [Evd 33,81] - <i>Me institucione politikbërëse</i> - <i>Ka marrëveshje me RASH</i> - <i>Urdhërat profesionale (Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë)</i> - <i>Punëdhënës të fushës farmaceutike</i> - <i>Anëtarësimi në rrjete (netëork) - AUF, BUA, ADRION</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	GVJ konstanton se kriteri përmbushet plotesisht. Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me subjekte farmaceutike [Evd 156] etj. Praktika profesionale zë një vend të konsiderueshëm në kurrikulën e programit, ajo rregullohet me rregulloren specifike.[Evd.157,158,159]. Të gjitha këto marrëveshje kanë impakt mjaft të rëndësishëm në ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. Gjatë katër viteve të fundit, kanë kryer praktikën profesionale rreth 350 studentë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimoreshkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	UMT ka realizuar marrëveshje me IAL të huaja të cilat ofrojnë programin e studimit Master i Shkencave në Farmaci. Si rezultat i projekteve të ndryshme Erasmus etj. është mundësuar mobiliteti i stafit akademik si dhe i studenteve. UMT ka ndëjekur praktika të mira juridike bazuar në ligj dhe rregullore të brendshme për të garantuar dhe inkurajuar mobilitete të stafit akademik/administrative sikurse edhe student. [Evd.31,32,34].
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të	Njësia përgjegjëse për programin e studimit për çdo vit akademik harton raporte analitike mbi mbarëvajtjen e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare [Evd. 33]. Rezultatet e bashkëpunimeve

përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	bëhen publike dhe të aksesueshme për gjithë stafin akademik dhe studentet nëpërmjet leksioneve të hapura si edhe përditësimit të literaturës të përdorur në programin e studimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	<p>Nëpërmjet qendrave universitare dhe shërbimeve të specializuara, stafi akademik kryen pjesën më të madhe të aktivitetit kërkimor shkencor.</p> <p>Në nivel universiteti funksionon Njësia e Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare e cila koordinon për gjithë universitetin aktivitetet e kërkimit shkencor, projektet dhe studimet që kryhen në Universitet.</p> <p>IAL siguron lirinë akademike, duke mbështetur stafin në studime e kërkime shkencore, aktivitete shkencore sukrse pjesëmarrjen në projekte të ndryshme kërkimore e shkencore.</p> <p>Ndërkohë, në buxhetin e UM nuk ka një fond të përcaktuar për mbështetjen financiare të stafit akademik në rast pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe publikime në revista të caktuara me pagesë.</p> <p>Universiteti dhe Fakulteti i kushtojnë një rëndësi të veçantë etikës profesionale të kërkimit e studimit dhe publikimit [Evd.16]. Bazuar në aktet rregullatorë të universitetit dhe fakultetit, UMT dhe FM synojnë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kërkimi shkencor të realizohet në përputhje me parimet universale të kodit etik të kërkuesit dhe studiuesit shkencor</li> <li>– nëpërmjet debatit aktiv të ndërgjegjësojë kërkuesit shkencorë për impaktet dhe implikimet që mund të kenë në rastet e shkeljes së parimeve themelore të kërkimit, kopjimit, plagjiaturës</li> <li>– parandalojë dhe ndëshkojë praktikatat korruptive të konfliktit të interesit në kërkimin shkencor, plagjiaturës në kërkim dhe publikimin e rezultateve të kërkimit.</li> </ul> <p>Institucioni nëpërmjet komisionit të Etikës ndjek dhe shqyrton raste të ndryshme të abuzimit me pronësinë intelektuale.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Departamenti kryen analizën e kërkimit shkencor duke e bërë pjesë të raportit vjetor dhe e bën publike bashkë me raportin vjetor të Fakultetit të Mjekësisë. [Evd.84,85].</p> <p>Përgjegjësi i departamentit harton dokumente përmbledhëse me rezultatet e kërkimit dhe informojnë zv. Dekanin për kërkimin shkencor. [Evd.107,164].</p> <p>Zv. Dekani për kërkimin shkencor realizon në mënyrë periodike analiza, raportime dhe publikon të dhëna për kërkimin shkencor.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve	Në mbështetje të promovimit të aktivitetit kërkimor, FM ka në

në fushën e kërkimit shkencor.	dispozicion Revistën shkencore “Neë Bulletin of Medical Sciences ISSN”, kurse UMT ka vendosur në dispozicion “The Albanian Journal of Medical and Health Sciences” (AJMHS) ISSN. [Evd.106,110,111,146]. Në këto dy revista personeli akademik dhe studentët inkurajohen të botojnë aktivitetin kërkimor.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.	Ndër dokumentat e ngarkuar nga IAL për akreditimin e programit “Master Shkencor” në “Farmaci”, <i>GVJ aktual nuk ka në dispozicion asnjë Marrëveshje të Transferimit të Materialeve (Material Transfer Agreement MTA) për bashkëpunimet individuale të stafit akademik në nivel ndërkombëtare ku mbrohet pronësia intelektuale.</i> Dokumenti i vetevleresimit citon se institucioni nëpërmjet komisionit të Etikës ndjek dhe shqyrton raste të ndryshme të abuzimit me pronësinë intelektuale, mirepo evidenca per kete mungon.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Pjesë e veprimtarive kërkimore e shkencore janë dhe studentët ku nëpërmjet udhëheqësve apo tutoreve ata mund të botojnë në revistat shkencore të fakultetit dhe universitetit. [Evd.18,106,111,112,115]. Studentet përfshihen në kërkim shkencor jo vetëm gjatë vitit akademik, por kyesisht gjatë zhvillimit të punimeve të diplomave. Kopje të punimeve të diplomave arkivohen të printuara dhe ne formë elektronike në bibliotekën e fakultetit. [Evd.73,104,105]. Ndërkohë, në aktivitete të organizuara nga fakulteti, angazhimi i studentëve ka qenë prioritet. Seksione të posaçme me prezantime të punimeve të studentëve janë pjesë e vazhdueshme e këtyre aktiviteteve. [Evd.111]. Studentët janë mbështetur vazhdimisht për tu përfshirë në veprimtari studimi e kërkimi në forma të ndryshme.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Kuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Kuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit Master i Shkencave në Farmaci është organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë LAL 80/2015 si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”. Konkretisht, është organizuar në lëndë dhe module të





Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 60 kreditesh në një vit akademik dhe me kohëzgjatje 5 vjeçare (total 300 ECTS). [Evd.61-68]. Ngarkesa mësimore mesatare e studentit nuk tejkalon 25 orë në javë.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programet e lëndëve janë hartuar në mënyrë që studenti të fitojë njohuri të thelluara dhe me gamë të gjerë në fushën farmaceutike si në aspektin e sintezës së barnave, kontrollit fiziko-kimik të formave farmaceutike, teknologjisë farmaceutike e kozmetike, përgatitjeve galenike, kimisë farmaceutike, farmakologjisë klinike, fitoterapisë, biofarmacisë dhe fushës së legjislacionit farmaceutik. [Evd.64].
<b>Kriteri 3.</b> Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ai synon pajisjen me njohuritë bazë dhe ka përmbajtje të tillë që tu ofrojë studentëve njohuritë bazë dhe të avancuara për të ndjekur ciklin e tretë të studimit. [Evd.61].
<b>Kriteri 4.</b> Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i integruar i studimit, duke ofruar njohuri jo vetëm në disiplinat profesionale por edhe në ato integruese dhe të fushës së praktikës profesionale [Evd.158,159] ka për qëllim të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në tregun e punës si dhe për të zgjidhur çështje komplekse dhe inovative në fushat e aplikuara profesionale.
<b>Kriteri 5.</b> Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet përbërëse të strukturës së programit konform ligjit të ri të armit të lartë.
<b>Kriteri 6.</b> Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Programi i integruar i studimit ofron një gamë të gjerë njohurish në kategorinë e lëndëve të formimit të përgjithshëm A (33.67 %) , lëndëve karakterizuese profesionale B (41 %), lëndë formuese të ngjashme dhe /ose integruese me diplonën karakterizuese C(11.67 %), lëndëve formuese për njohjen e gjuhës së huaj, praktika, stazhe) D (11%) dhe detyrime përmbyllëse –teza e diplomës E (2.66%).</p> <p>Një përqindje të konsiderueshme të programit të studimit e zë dhe praktika profesionale me 22 kredite e cila realizohet në përputhje me rregulloren specifike [Evd.158] dhe në bashkëpunim me rrjetin farmaceutik nëpërmjet kontratës individuale për çdo student. Në kontratë specifikohen të drejtat dhe detyrimet e praktikantit, ngarkesa mësimore, orari dhe periudha e zhvillimit. Studenti është i detyruar të mbajë dhe të plotësojë librezën e praktikës profesionale, e cila pasi siglohet nga drejtuesi i praktikës dorëzohet në përfundim të saj tek pedagogu përgjegjës. Zhvillimi i praktikës profesionale monitorohet nga pedagogët përgjegjës të lëndës. [Evd.159].</p>
<b>Kriteri 7.</b> Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Programi i studimit gjithashtu parashikon edhe zhvillimin e temës së diplomës në përfundim të studimeve me 8 kredite, e cila zhvillohet në vitin e fundit të studimeve nën udhëheqjen e një pedagogu përgjegjës në përputhje me rregulloren specifike [Evd.158]. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën “Master i





	<p>Shkencave” në programin e studimit “Farmaci”, të firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i Universitetit, e cila është dokument zyrtar.</p> <p>Modeli i diplomës është miratuar nga Senati Akademik dhe MASR. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar. [Evd.67, 68].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Mjekësisë përbëhet nga 16 departamente të cilët përmbushin kriteret ligjore. Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, pjesë e Fakultetit të Mjekësisë, UMT, i cili përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti përbëhet nga 11 staf akademik dhe 6 staf ndihmës-akademik. Të gjithë anëtarët kanë grada e tituj, ku specifikiisht 3 anëtarë kanë fituar titullin akademik “Profesor”, 4 anëtarë kanë fituar titullin “Profesor i Asociuar” dhe 4 anëtarë të tjerë kanë fituar gradën “Doktor i Shkencave” duke plotësuar kriteret ligjore dhe standardet për të ofruar programin e studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës, ku rreth 70 % e ngarkesës mësimore të programit të studimit e realizojnë stafi me kohë të plotë në përputhje të plotë me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit akademik dhe pjesa tjetër nga stafi me kohë të pjesshme [Evd.139]. Nga 75 staf akademik që mbulojnë programin e studimit, 41 janë PAE dhe 34 PAK
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Njësia bazë në strukturën e saj ka 6 staf akademik ndihmës në mbështetje të e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Përgjegjësi i Departamentit, i cili luan njëkohësisht rolin e koordinorit të programit, përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Të gjitha proceset e vendimmarrjes në funksion të programit të



	studimit që kanë nevojë për miratim, diskutohen gjerësisht e miratohen në Departament dhe më pas në Dekanat ku miratohen. [Evd.166].			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Përgjegjësi i Departamentit informon vazhdimisht drejtuesin e Fakultetit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera që realizohen gjatë vitit akademik. Përgjegjësi i Departamentit në mbledhjet e departamenteve mund të marrë pjesë dhe raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet si edhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Departamenti i Farmacisë si njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit, disponon dokumentacionin e plotë për programin e studimit [Evd.61-69] ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dhëna të përgjithshme për njësinë dhe programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj.</li> <li>- rregullorja e programit,</li> <li>- plani mësimor;</li> <li>- syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht,</li> <li>- CV e personelit akademik.</li> </ul> <p>Syllabuset e lëndëve janë përshtatur në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 duke pasqyruar të gjithë elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi. [Evd.64]</p> <p>I Plani mësimor në fillim të çdo viti akademik rishikohet nga njësia dhe forma finale miratohet në senat për tu zbatuar në vitin akademik në vijim. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulën, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën. [Evd.64]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar dhe ka respektuar kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të kategorizuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-A (33.67 %), lëndë të formimit të përgjithshëm 101 kredite;</li> <li>- B (41 %), lëndëve karakterizuese profesionale 123 kredite;</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i integruar i	



<p>studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>- C(11.67 %), lëndë formuese të ngjashme dhe /ose integruese me disiplina karakterizuese 35 kredite;          - D (11%) lëndëve formuese për njohjen e gjuhës së hauj, praktika, stazhe 33 kredite;          -E (2.66%).detyrime përmbyllëse –teza e diplomës 8 kredite  <b>[Evd.62-63].</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në planet mësimore përfshihet informacioni i nevojshëm me karakter të gjerë informativ dhe praktik. Plani mësimor është në përputhje me kurrikulën e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik.          Në planin mësimor të programit të studimit dhe në syllabuset e lëndëve paraqiten të dhëna të detajuara mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra;</li> <li>– Numrin e krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve (leksione seminare, laboratorë);</li> <li>– Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë);</li> <li>– Mënyrat e kontrollit të dijeve të çdo moduli. <b>[Evd.64]</b></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve në programin e studimit është i përcaktuar në Rregulloren e universitetit, fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit <b>[Evd.58,66]</b>.          Ndërkohë, çdo vit akademik me propozim të Fakultetit, Senati akademik i UMT miraton kriteret specifike të pranimit në programin e studimit për vitin pasardhës. Këto kriteret bëhen publike dhe dërgohen në MASR dhe QSHA për tu njohur nga maturantët. <b>[Evd.36-39]</b>. Procesi i pranimit është i menaxhuar nga QSHA dhe RASH ndërkohë që UMT bën vetëm renditjen dhe shpalljen fitues të maturantëve në bazë të renditjes. <b>[Evd.40-42]</b>.          Pavarësisht se regjistrimi dhe transferimi i studimeve rregullohen me akte të përvitshme të MASR, institucioni ka parashikuar procedurën se si kryhen transferimet e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes, transferimi i studimeve, transferimi i studimeve në të njëjtin cikël studimi, procedurat e transferimit, si dhe ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen. Rregullorja e universitetit parashikon rastet dhe sasinë e krediteve përkatëse që njihen. <b>[Evd.47,164]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Përmbajtja e plotë e programit të studimit u vihet në dispozicion studentëve gjatë javës së parë të fillimit të vitit akademik. Po ashtu, njësia bazë vë në dispozicion të studentëve Manualin e studentit i cili përmban informacione të detajuara, jo vetëm për programet e studimit por dhe për mënyrën e realizimit të tyre dhe infrastrukturën mbështetëse. <b>[Evd.90]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi i studimit ka qenë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, përfshirë këtu syllabuset, literaturën, kriteret e pranimit etj. Ky proces inicohet me Urdhër të Rektorit të Universitetit, i cili kërkon në përfundim të çdo viti akademik që Fakultetet dhe Departamentet e Universitetit të kryejnë ndryshime</p>



	eventuale (nëse ka) në programet e tyre. [Evd.47,164]. (Evidenca për arkivimin e dosjes në anglisht mungon).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit është ndërtuar dhe organizuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi, por edhe zbatohet në përputhje me udhëzimet kronologjike përkatëse sipas viteve akademike.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Kjo deshmohet nga suksesi I larte I provimin e licensimit. [Evd.56].
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Ngarkesa mësimore e programit të studimit është e ndarë në orë në auditor dhe orë jashtë auditorit, ku mbi 50 % të orëve e zënë orët e leksioneve. Në zbatim të sistemit të Bolonjës ku 1 ECTS është ekuivalent me 25 orë, prej tyre një pjesë realizohen në auditor dhe një pjesë jashtë auditorit, raport që ndryshon në varësi të tipit të veprimtarisë mësimore të zhvilluar. Mesatarisht në një vit akademik janë parashikuar 1500 orë totale, ku mbi 50 % të tyre janë orë jashtë auditorit dhe ngarkesa mesatare javore e studentit luhet 20 - 25 orë, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Ngarkesa mësimore javore shpërndahet në mënyrë të harmonizuar në orë 50 minutëshe gjatë ditëve të javës në leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika. [Evd.102].
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstanton se kriteri përmbushet plotësisht. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, sidomos ato në rajon.
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i integruar i studimit është emërtuar në përputhje me LAL 80/2015, i përket ciklit të dytë të studimeve, me kohëzgjatje 5-vjeçare si program i integruar studimi me titull "Master i shkencave" në "Farmaci" ku elementët përbërës janë harmonizuar në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të aftësohen me njohuri të thellë profesionale, por edhe të kenë njohuri dhe kompetenca për të vazhduar ciklin e tretë të studimeve siç janë studimet e doktoratave



	<p>të cilat njësia bazë i ofron prej vitesh sipas <i>VKM Nr. 41.dt. 24.01.2014 dhe Udhëzimit Nr. 31. dt. 29.12.201.</i> Raporti teori/praktike në programin e studimit ka qenë një nga pikat e forta duke patur vazhdimisht një përqindje të lartë të orëve laboratorike për lëndët me natyrë profesionale dhe integruese. <b>[Evd.61-65]</b>. Kurrikula është e ngjashme dhe e përafërt me kurrikulat ndërkombëtare si në përmbajtjen e disiplinave mësimore, po ashtu edhe në peshën e krediteve përkatëse</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamenti dhe personeli akademik, krahas eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorë si Urdhrit e Farmacistëve të Shqipërisë, Shoqatën Farmaceutike të Shqipërisë etj. <b>[Evd.71]</b> si dhe me studentë të diplomuar (alumni) për të rritur jo vetëm cilësinë e programit por dhe për të mundësuar transferimin, mobilitetin dhe punësimin e integruar në tregun global pas përfundimit të studimeve. <b>[Evd.151]</b>.</p> <p>Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas përcaktimeve të <i>VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018</i>: pika 2.8 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura e detyruar dhe ajo e këshilluar. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga titullarët e lëndëve të cilët njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Rishikimi apo përditësimi në përmbajtje të programit të studimit kryhet çdo vit akademik dhe inicohet në nivel institucional për të gjitha programet e universitetit <b>[Evd.46.47]</b>. Plani mësimor i miratuar nga Senati akademik dhe dosja e plotë e programit zbatohet në vitin akademik pasardhës</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit duke pasur një raport optimal të veprimtarive formuese, program të lëndëve bashkëkohor si dhe një peshë të mirë-organizuar midis lëndëve në kredite dhe orë i plotëson më së miri objektivat formues, duke diplomuar studentë të aftë për tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit duke pasur një raport optimal të veprimtarive formuese, program të lëndëve bashkëkohor si dhe një peshë të mirë-organizuar midis lëndëve në kredite dhe orë i plotëson më së miri objektivat formues, duke diplomuar studentë të aftë për tregun e punës por edhe me kompetenca të plota për të vazhduar studimet e ciklit të tretë. Nga ana tjetër, ndarja në module e lëndëve mundëson mobilitetin e studentëve, i cili ka ardhur në rritje si <b>[Evd.31-34]</b> dhe jep mundësi për transferimin e studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin</p>	<p>Pikë e fortë e programit të studimit është edhe reflektimi i kërkesave dhe të dhënave të strukturave të rregullimit të profesionit dhe tregut profesional në kurrikulën e studimit, e cila arrihet në disa mënyra:</p> <p>a) Një pjesë e konsiderueshme e stafit akademik ushtrojnë dhe</p>




<p>parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>profesionin, të cilët duke qenë afër me zinxhirin farmaceutik lehtësojnë komunikimin me dinamikën e tregut të punës. Madje, ata vetë shpesh herë janë punëdhënës të të diplomuarve, duke parë dhe vlerësuar nga afër formimin e tyre. [Evd.144].</p> <p>b) Bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm të tregut profesional, sugjerimet e tyre dhe aktivitetet e përbashkëta gjithashtu kanë ndikuar në kurrikulën e programit.</p> <p>c) Të dhënat nga QSHA e cila raporton për provimin e licensimit [Evd.56].</p> <p>d) Të dhënat e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë në lidhje me rezultatet e praktikës profesionale, licensimin dhe punësimin e tyre, ku më i fundit tregon se të diplomuarit e këtij programi kanë 100% kalueshmëri, dhe gati 84 % prej tyre ushtrojnë profesionin në RSH dhe gati 80 % e tyre në rajonin e Tiranës. Nga këta, rreth 10 % e tyre janë pjesë e administratës publike dhe 15 % pjesë e industrisë farmaceutike. Punësimi i të diplomuarve në këto shifra tregon se ata janë të kërkuar dhe të vlerësuar nga tregu i punës. Gjithashtu, drejtimi i institucioneve kryesore të fushës farmaceutike sot bëhet nga të diplomuarit në këtë program studimi. [Evd.71].</p> <p>e) Të dhënat nga RASH në lidhje me cilësinë e studentëve në hyrje të programit rezultojnë me një mesatare të lartë, e cila është mbi notën 9, duke treguar një kërkesë të lartë nga maurantët për këtë program dhe një rritje në vitin e fundit akademik në 9.5. [Evd.56].</p> <p>f) Analiza e gruplëndëve që janë kriter hyrës për programin në tre vitet akademike të fundit e realizuar në nivel institucional, e cila rezulton me një përmirësim të qëndrueshëm, ku 50 % e studentëve ruajnë të njëjtat mesatare për këto gruplëndësh. [Evd.165].</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>GVJ konstanton se kriteri permbushet plotësisht. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor dhe prania e studentëve në institucion prej 5 vitesh, mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me**

<b>fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.	Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme është punësuar në përputhje me kriteret ligjore dhe institucionale në fuqi. UMT ka të miratuar procedurat e rekrutimit të stafit akademik. [Evd.35,79].
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Stafi me kohë të plotë në përputhje me LAL 80/2015 është i pajisur i gjithë me grada shkencore dhe tituj akademikë dhe të klasifikuar në kategoritë përkatëse. Në Departamentin e Farmacisë, në vitin akademik 2018-2019, janë angazhuar në përmbushjen e procesit mësimor 11 (njëmbëdhjetë) pedagogë me kohë të plotë (staf i Departamentit të Farmacisë), 32 pedagogë me kohë të plotë (staf i Departamenteve të tjera të Fakultetit të Mjekësisë), 6 pedagogë të ftuar, 23 pedagogë me kohë të pjesshme; nga këta të fundit, 10 janë pedagogë për Shkencat Bazë Formuese (Module të përbashkëta me programin e studimit “Master i Shkencave” në “Mjekësi”). I gjithë stafi akademik ka grada ose tituj akademik (3 me titull Prof, 4 Prof. Asoc. dhe 4 me gradën shkencore Dr).</p> <p>Ngarkesa në ore e stafit bazohej në Udhëzimin 29 të MASR. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është:</p> <p>a) Kategoria Profesor: 140 orë  b) Kategoria Lektore: 165 orë  c) Asistent-Lektore 195 orë</p> <p>Cdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përlllogaritet sipas koeficienteve dhe paguhet e plotë nga IAL-te. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulohe edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 ore.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë nese kategorizohet me orientim kërkimor sipas procedurave të parashikuara nga IAL mund të këtë ulje të detyrimit të ngarkesës mësimore në auditor dëri në 35% sipas përcaktimeve në aktet e brendshme të IAL-së. Orët suplementare në auditor për personelin akademik me orientim kërkimor nuk mund të jenë me shumë se 100 orë. GVJ konstaton se stafi akademik dhe Departamenti i Farmacisë zbaton me korrektësi këtë udhëzim. Bazuar në evidencat e dorëzuara nga IAL, nuk kishte raste të mbingarkesës mësimore të stafit të angazhuar në këtë program.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e	Fusha e ekspertizës së stafit akademik përputhet me gruplëndët që ata mbulojnë si dhe me fushën kërkimore të tyre. [Evd.69] Pjesa më e madhe e stafit akademik ka eksperiencë kërkimore dhe kjo dëshmohet me botime brenda dhe jashtë vendit të publikuara në



studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	revista të rankuara në website-et të rëndësishme shkencore dhe kërkimore (Scopus,) dhe me impact factor (Journal Citation Report) [Evd.84,107,108]. Aktiviteti kërkimor është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe linjat e kërkimit të miratuara në njësinë bazë [Evd.61].		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Praktika profesionale realizohet në vitin e fundit të studimeve me një peshë prej 22 kreditesh në përputhje me rregulloren specifike. Ajo realizohet nën drejtimin e pedagogut përgjegjës dhe me mbështetjen e të gjithë stafit akademik përgjegjës për programin e studimit. Praktika profesionale gjithashtu realizohet në kuadër të kontratë-marrëveshjes me një numër të konsiderueshëm të subjekteve private farmaceutike, ku specifikohen të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe udhëheqësit personal të praktikës profesionale, periudha e qëndrimit si dhe penalitetet. Gjatë kësaj periudhë studenti duhet të plotësojë librezën e praktikës e cila dëshmon veprimtarinë e zhvilluar gjatë periudhës së praktikës dhe firmoset nga subjekti farmaceutik çdo ditë. Në përfundim, në bazë të performancës gjatë kryerjes së praktikës profesionale si dhe provimit përfundimtar studenti vlerësohet me notën përkatëse. Gjithashtu, edhe tema e diplomës është një veprimtari specifike përmblyëse e cila zhvillohet në përputhje me LAL 80/215 dhe udhëzimet përkatëse (Udhëzimi 41 dt. 24.01.2018) me peshë prej 8 kreditesh. Tema e diplomës realizohet në përputhje me rregulloren specifike të diplomës ku përmenden formati, raportet e pjesëve përbërëse, plagjiatura, bibliografia si dhe procedurat e dorëzimit dhe prezantimit. [Evd. 73,104,105].		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Në funksion të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” janë edhe 6 personel ndihmës akademik dhe ndihmës administrativ. Nga këta, 4 punonjës ndihmës akademik në funksion të procesit mësimor, 1 personel ndihmës akademik në funksion të procesit kërkimor, si dhe 1 personel ndihmës administrativ në funksion të proceseve administrative. Personeli ndihmës akademik është i qëndrueshëm prej shumë vitesh dhe si i tillë ka ekspertizën dhe kompetencat e duhura për realizimin e orëve laboratorike, mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike në përputhje me specifikat e programit të studimit. [Evd.76]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b> <b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

**Standardi II.6**

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat

Strukturat përgjegjëse për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës konsultohen dhe përfshijnë propozimet e aktorëve kryesorë brenda institucionit por edhe jashtë tij si:



<p>përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë</li> <li>- Qendra e Edukimit në Vazhdim</li> <li>- Qendra e Shërbimeve Akademike</li> <li>- Subjektet farmaceutike jopublike</li> <li>- Përfaqësitë farmaceutike</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët aktualë dhe Alumni janë në mënyrë të vazhdueshme të përfshirë në diskutime për përmirësimin e programit të studimit. Ndër strukturat tjera që marrin pjesë në përmirësimin e programit të studimit janë edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Drejtoria e kurrikulave UMT</i>, e cila është përgjegjëse për harmonizimin e kuadrit ligjor në programet e studimit dhe në kuadër të zbatimit të tyre në planet mësimore shpesh herë inicion procesin në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UMT. [Evd.47]</li> <li>- <i>Sekretaritetë mësimore</i> të cilat janë hallka të rëndësishme teknike për zbatimin e programeve të studimit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Alumni janë në kontakt të vazhdueshëm me departamentin në sajë të aktiviteteve të përbashkëta me subjektet farmaceutike por edhe në sajë të edukimit në vazhdim, duke pasur mundësinë dhe hapësirën për të reflektuar përmirësime në kurrikulën e programit të studimit. [Evd.96,101,113]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	<p>Ndër strukturat bashkëpunuese jashtë institucionit në përmirësimin e programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë</li> <li>- Qendra e Edukimit në Vazhdim</li> <li>- Qendra e Shërbimeve Akademike</li> <li>- Subjektet farmaceutike jopublike</li> <li>- Përfaqësitë farmaceutike</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme</p>	<p>Bashkëpunimi me institucione publike dhe jo publike, shoqata, rrjetet e profesionistëve, institute kërkimore e shkencore është pjesë integrale e Departamentit të Farmacisë. Bashkëpunimi me universitete të tjera publike dhe jo publike, vendase dhe të huaja rrjedh nga marrëveshjet e realizuara në nivel institucional [Evd.28,33,34,81,86]. Bashkëpunimet me institucionet politikbërëse, shoqata, dhe Urdhëri profesional, Departamenti ka përfaqësues në disa institucione apo grupe pune që reflektohen në përmirësimin e kurrikulës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë (1)</li> <li>- Përfaqësues në QSHA në komisionin e licensimit profesional (3)</li> <li>- Përfaqësues në grupet e punës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (4-5 veta)</li> <li>- Përfaqësues në grupin e punës në lidhje me zbatimin e procesit</li> </ul>



	të Bolonjës - Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - Përfaqësues në Borde revistash brenda dhe jashtë vendit - Përfaqësues në ASCAL si ekspertë të jashtëm të vlerësimit (6) - Përfaqësues në Strategjinë e Integritimit 2016-2020 të kuadrit ligjor në BE - Përfaqësues në Shoqata profesionale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi II.7****Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>GVJ konstanton se kriteri përmbushet plotësisht. Përmbajtja e programit të studimit është hartuar për të ofruar jo vetëm njohuri dhe aftësim profesional, por jep orientim të qartë të studentëve drejt studimeve dhe kërkimit shkencor [Evd.4,61].</p> <p>Në objektivat e programit janë përcaktuar disa synime në lidhje me përgatitjen e thelluar në fushën profesionale dhe kërkimin shkencor. Lëndët si <i>Metodologji e Kërkimit Shkencor, Analizë farmaceutike I, Përgatitjet galenike</i> etj. të parashikuara në planin mësimor kanë për qëllim ta përgatisin studentin jo vetëm me njohuritë paraprake mbi hulumtimin dhe kërkimin, por dhe ti japin atij mundësitë që ti praktikojë dhe të veprojë në mënyrë të pavarur në kërkime e studime. [Evd.64].</p> <p>Angazhimi në kërkim shkencor, nga njësitë, personeli akademik dhe studentët kërkon mbështetje në forma të ndryshme nga ana e Fakultetit.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet që zhvillon Fakulteti në shumicën e rasteve është falas ose me një tarifë simbolike. Pavarësisht mbështetjes së ulët financiare të Fakultetit, personeli akademik nëpërmjet financimeve alternative, projekteve dhe donacioneve angazhohet në kërkim dhe mobilitet [Evd.84,89,95,107,111].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Angazhimi në kërkim shkencor, nga njësitë, personeli akademik dhe studentët kërkon më shumë mbështetje nga ana e UMT.</p> <p>Departamenti bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore në bashkëpunim me personelin akademik duke respektuar lirinë akademike si dhe duke integruar dhe studentët. Nëpërmjet orientimit nga personeli akademik, studentët angazhohen dhe marrin pjesë në punime, projekte, aktivitete të karakterit studimor dhe kërkimor shkencor. Në 3 vitet e fundit janë përfshirë në aktivitete të tilla rreth 161 studentë [Evd.98]. Një pjesë e punimeve që kanë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	

	<p>arritje të vlerësuara në fushën e kërkimit publikohen në librin e abstrakteve brenda dhe jashtë vendit (p.sh. Greqi.) [Evd.111,112], si dhe në dy revistat.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet që zhvillon Fakulteti në shumicën e rasteve është falas ose me një tarifë simbolike. Pavarësisht mbështetjes së ulët financiare të Fakultetit, personeli akademik nëpërmjet financimeve alternative, projekteve dhe donacioneve angazhohet në kërkim dhe mobilitet. [Evd.84,89,95,107,111].</p> <p>Për studentët, në kuadër të zhvillimeve të fundit në arsimin e lartë, është përmirësuar mbështetja financiare duke ulur tarifat e studimit, duke atashuar bursa për studentët ekselentë, për studentët në nevojë, dhe studentët e kategorive të marginalizuara, si dhe duke ofruar shërbime publike me tarifa të reduktuara nëpërmjet kartës së studentit [Evd.126,127,128,129]. Gjithashtu, në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” janë mbështetur për kërkimin shkencor në kuadër të mobilitetit edhe studentë të huaj për periudha disa mujore.</p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit inkorpon hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar për akreditimin e këtij programi të integruar master, FM në buxhetin e saj nuk ka një fond të përcaktuar për të mbështetur stafin akademik në projektet e tyre kërkimore. Departamenti i Farmacisë ka aplikuar për financime edhe nga fondi publik i kërkimit i AKKSHI ndërkohë me shumë përpjekje duhet bërë për shkrimin e granteve si kordinator në kuadër të thirrjeve ndërkombëtare si Erasmus, Cost, Horizon2020.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1261 762 1346">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="762 1261 986 1346">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="986 1261 1209 1346">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1346 762 1391"></td> <td data-bbox="762 1346 986 1391" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="986 1346 1209 1391"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<b>Standardi II.8</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Në zbatim të Statutit të UMT [Evd.1,2], rregullores dhe strategjisë së zhvillimit të institucionit, një numër aplikimesh për kërkimin shkencor është orientuar në drejtim të përmbushjes së objektivave specifike të programit të studimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar [Evd.30] duke stimuluar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor</p>	<p>Aplikimet për kërkimin shkencor janë përgjigjur dhe nga dhe kanë stimuluar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve.</p>

shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.				
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Në fushën e programit të studimit, Departamenti organizon në bashkëpunim me përfaqësues të rrjetit farmaceutik konferenca shkencore, aktivitete të edukimit në vazhdim, seminare e leksione të hapura, duke përfshirë si stafin akademik ashtu edhe studentët në funksion të garantimit të objektivave të programit të studimit. <b>[Evd.95,98]</b> Këto aktivitete u japin studentëve njohuri shtesë për një sërë grup lëndësh të programit të studimit, duke i aftësuar më tej të diplomuarit për tregun e punës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për shkak të specifikës që ka dhe natyrës së programeve të studimit që ofron, ka përshtatur dhe përdor një gamë të madhe metodash në mësimdhënie. Avancimi i teknologjisë ka krijuar mundësinë e zhvillimeve inovative dhe bashkëkohore të metodave të reja në format e mësimdhënies dhe mësimnxënies. <b>[Evd.66]</b> Lëndët/modulet për shkak të natyrës ose për shkak se ofrohen nga disa pedagogë, organizohen në forma të ndryshme, përfshirë mësimdhënien tradicionale, mësimdhënien alternative duke ndërthurur teorinë dhe praktikën duke nxitur të nxënit aktiv dhe të menduarit kritik. <b>[Evd.61,62,117]</b> . Ndër to përmendim: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënien ndërvepruese</li> <li>- Mësimdhënien me qendër studentin</li> <li>- Mësimdhënien e diferencuar</li> <li>- Mësimdhënien e integruar</li> <li>- Mësimdhënien tematike</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënien nepermjet projekteve etj</li> </ul> <p>Metodat inovative të mësimdhënies ndihmojnë gjithashtu edhe stafet akademike dhe trajnuesit të krijojnë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit të cilat garantojnë edhe përfshirjen e studentëve në to si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktualisht UMT është duke vënë në zbatim pjesën e projektit të Simulimit klinik ku një vend të rëndësishëm zë mësimdhënia me metoda inovative të simulimi virtual, anatomisë 3D, edukimit në distancë etj. [Evd.29]</li> <li>- Moodle – LMS (Learning Management System); aplikacioni do të mundësojë menaxhimin e procesit të edukimit në vazhdim si nevojë e vazhdueshme e edukimit dhe trajnimit të profesionistit të shëndetësisë [Evd.57]</li> <li>- Moodle – Aktualisht po mundësohet futja e platformës Moodle për stafin dhe studentët e FM. Në këtë kuadër janë planifikuar trajnime dhe takime lidhur me funksionalitetin e kësaj platforme. [Evd.57]</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në nivel institucional ndërsa në nivel fakulteti, ky proces monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga njësitë bazë dhe nga Dekanati. [Evd.12,13]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në monitorimin e cilësisë së mësimdhënies është bere nëpërmjet KSFM, ku Fakulteti ka marrë mendimin e tyre në lidhje me problematika të hasura [Evd.45, 97]. Gjatë vizitës në IAL, Përgjegjësi i Departamentit të Farmacisë, Dekani i FBU dhe Zv. Rektorët e UM garantuan se raporti i realizuar nga ASCAL në kuadër të sondazhit kombëtar të studentëve do të jetë pjesë e analizës në nivel njësie kryesore dhe institucional për përmirësimin e cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>UMT ka synuar vazhdimisht zhvillimin e veprimtarive akademike në përputhje me standardet e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj [Evd.9-11]. FM është angazhuar maksimalisht në plotësimin e standarteve, pasqyruar këto edhe në vlerësimin e kryer nga ASCAL – QAA dhe akreditimin e UMT me 5 vite, duke u vlerësuar kështu si institucioni më i mirë në institucionet publike në vend [Evd.15].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Institucioni, për të zhvilluar sa më mirë metodat inovative të mësimdhënies ka ofruar për stafin akademik edhe mbështetje teknologjike, siç është rasti i pajisjes së stafit me tablet në funksion të procesit mësimor. [Evd.119].</p> <p>Institucioni në mënyrë të vazhdueshme nxit marrëdhënien e ngushtë student-lektor (kjo ishte e evidente edhe pas takimit me studentet) sikurse inkurajon stafin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe rezultatet e të nxënit.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi III.2**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë të shumta dhe në varësi të llojit, specifikës së veprimtarive formuese, por edhe lirisë së veprimit që ka personeli për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. Ndërthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe atyre profesionale, përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara [Evd.61-64]. Në programin e studimit format e mësimdhënies janë të përcaktuara qartë për çdo lëndë, të cilat përfshijnë leksione, seminarë, ushtrime, laboratore, praktika dhe projekte. [Evd.65]
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik pranon dhe respekton diversitetin, është i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. [Evd.57]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Fakulteti mundëson infrastrukturën e nevojshme për të plotësuar nevojat që kanë lëndë/module të ndryshme për tu realizuar jo vetëm brenda fakultetit, universitetit dhe QSUT [Evd.50, 123, 124], por në raste specifike si p.sh. për lëndët Fizikë dhe Biologji, studentët të realizojnë laboratorët në infrastrukturë të dedikuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT. [Evd.26]. Sallat kryesore janë të pajisura me sisteme audio-vizive (projektorë), ndërsa laboratorët me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikave mësimore e profesionale. [Evd.124].
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ evidenton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përdortë metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit, nga ato tradicionale dhe interaktive.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e	Institucioni në mënyrë të vazhdueshme përfshin studentët në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies. Sugjerimet e tyre analizohen nga grupi i punës dhe reflektohen në raportet periodike.




sugjerimet e tyre.				
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Personeli akademik është i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Format dhe metodat e mësimdhënies synojnë përgatitjen e studentit me aftësitë profesionale që sigurojnë pavarësi mendimi e veprimi dhe e përfshijnë atë në vendimmarrje dhe gjykime. [Evd.61-66].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ konkludon se kriteret 1-2 të standardit III.3 përmbushen plotësisht. Për realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” janë përgjegjëse të gjitha strukturat e FM. Procesi mësimor për programin e studimeve kryesisht zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit. Këto ambiente përfshijnë:
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	<p><b>1. Godina e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” (2 kate)</b></p> <p>Godina në funksion të programit përbëhet nga 2 kate, ku secila prej tyre ka laboratorët si më poshtë: Kati III - Ka në total 4 laboratorë (Lab. i Analizës së Drogave, Lab. i Përgatitjes Galenike, Lab. i Përgatitjeve kozmetike, Lab. i Kimisë Toksikologjike), 2 preparatorë, 9 zyra (2 për stafin administrativ dhe 6 për stafin akademik). Kati IV - Ka në total 5 laboratorë (4 laboratorë mësimorë - Lab. i Analizës Farmaceutike, Lab. i Kimisë Analitike, Lab. i Kimisë inorganike, Lab. i Kimisë Organike - dhe 1 laborator kërkimor), 2 preparatorë si dhe 3 zyra në funksion të stafit akademik.</p> <p><b>2. Ambientet e strukturave shëndetësore universitare</b> (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë), të cilat përfshijnë të gjitha sallat mësimore bibliotekat etj. Në këtë infrastrukturë ofrohen një sërë laboratorësh në funksion të programit të studimit:</p> <p>- Lab. i Farmakologjisë, Lab. i Anatomisë, Lab. i Mikrobiologjisë, Lab. i Biokimisë, Lab. i Histologjisë, Lab. i Fiziologjisë, Lab. i Simulimit klinik, Lab. i Informatikës etj.</p> <p><b>3. Godina qëndrore e FM,</b> ku kryesisht është e vendosur sekretaria</p>



	<p>mësimore në funksion të programit të studimit, si dhe administrative në nivel të njësisë kryesore.</p> <p>Gjithashtu, infrastruktura përbëhet edhe nga ambiente zyrash për stafin administrativ, ambiente zyrash për shefat e departamenteve, ambiente zyrash për sekretarinë mësimore, sallë biblioteke, etj. [Evd.90].</p> <p>Për shkak të ngjarjes së jashtëzakonshme, tërmeti i 26 nëntor, 2019, një pjesë e godinave në shërbim të programit të studimit u prekën dhe plani i masave për rikonstrukcion është miratuar nga IAL, standarte bashkëkohore do të aplikohen duke korigjuar edhe mangësitë në infrastrukturë për individë me aftësi të kufizuara fizike. [Evd.45]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Një pjesë e mirë e sallave janë të ndërtuara me standarde bashkëkohore, të pajisura me projektor, sistem kompjuterik, mikrofon, për realizim në kushte komode të leksioneve të hapura. Këto salla shërbejnë për organizime eventesh të ndryshme shkencore që Fakulteti organizon me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkuara. Në këto ambiente realizohen kurse të ndryshme teoriko-praktike, leksione të hapura. [Evd.123,124]</p> <p>Në funksion të realizimit të procesit mësimor, mund të përdoren të gjitha ambientet e tjera që disponon universiteti. Fakulteti i Mjekësisë disponon infrastrukturë funksionale të shërbimeve informatike. Përveç aksesit në internet në të gjitha sallat, ëi-fi është i aksesueshëm në çdo mjedis të FM.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse për programin e studimit është e përditësuar dhe garanton marrjen e njohurive të nevojshme për formimin e profesionistëve në fushën e farmacisë dhe teknologjisë farmaceutike. [Evd.125,126].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka disa biblioteka në shërbim të studentëve të cilat mund të frekuentohen nga studentët dhe personeli akademik. FM ka bibliotekën e tij me rreth 30 vende studimi dhe një punonjës biblioteke.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në vitin akademik 2018 – 2019, në bashkëpunim me MASR, u vu në dispozicion të institucioneve shqiptare biblioteka on-line nga RASH (ULIBRARY) ku personeli akademik ka akses nëpërmjet llogarive personale që UMT [<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>] mundëson për akses në Sistemin e Menaxhimit [<a href="https://www.umt.esse3.u-gov.rash.al/Home">https://www.umt.esse3.u-gov.rash.al/Home</a>]</p> <p>Aksesi në këto librari është i mundur jo vetëm brenda institucionit por edhe jashtë tij. [www.umed.edu.al]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit,</p>	<p>Studentët kanë akses në infrastrukturën laboratorike [Evd.161] për realizimin jo vetëm për realizimin e detyrimeve laboratorike por edhe</p>



diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	studime të ndërmarra nga studentët në bazë të hipotezave shkencore të ngritura në bashkëpunim me udhëheqesin shkencor.			
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës, përdoren gjerësisht platforma cloud (google drive) e ofruar nga institucioni me akses nëpërmjet adresave personale të e-mailit ( <a href="mailto:emër.mbiemer@umed.edu.al">emër.mbiemer@umed.edu.al</a> )			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Shpërndarjen e leksioneve, detyrave dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët inkurajohen t'i kryejnë nëpërmjet sistemit të menaxhimit ESSE3 të UMT, platformës Google classroom etj, të cilat janë mjete ndihmëse në komunikimin dhe ndërveprimin midis stafit dhe studentëve.  Të dhënat në lidhje me leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund t'i kryejnë nëpërmjet sistemit të menaxhimit ESSE3 të UMT, platformës Google classroom etj, të cilat janë mjet ndihmës në komunikimin dhe ndërveprimin midis stafit dhe studentëve. [Evd.51-53]			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Stafi akademik orienton studentët për fushat studimore të grupeve kërkimore, studenti inkurajohet të vazhdoj hulumtimin në fushë e cila përbën interesin e tij kërkimor duke ndjekur edhe pasionin. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi ndjek nga afër studentin gjatë gjithë procesit si dhe kujdeset që punimi të jetë në përputhje me standardet e kërkuara dhe të plotësojë etikën e kërkimit dhe të pronësisë intelektuale. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. [Evd.105].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet përbashërisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në Statutin e ri të UMT është krijuar një sektor i posaçëm për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, pranë Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.  Kjo njësi organizonte pyetësorë me studentët, përpunonte të dhënat e përfuar dhe hartonte raporte, ku evidentoheshin pikat e forta dhe ato për përmirësim. Studentët pyetishi edhe për nivelin e mësimdhënies,



Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

	format e saj etj.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT dhe FM, fakulteti dhe departamentet janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit. Më shumë se një detyrim ligjor, ky proces gjithnjë e më shumë po zhvillohet në funksion të promovimit dhe ndërgjegjësimit të të gjithë personelit të FM në lidhje me cilësinë. Kjo strukturë do të bashkërendojë veprimtarinë e saj me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet.  Eksperiencia individuale e personelit akademik në fushën e sigurimit të cilësisë është mjaft e madhe. Gjatë periudhës 2016 – 2019 janë angazhuar nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit rreth 120 ekspertë të vlerësimit të jashtëm, pjesë e stafit të UMT, eksperiencia e të cilëve, natyrshëm është sjellë edhe në UMT dhe veçanërisht nga stafi i departamentit janë angazhuar rreth 6 anëtarë të Departamentit të Farmacisë
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Për zbatimin e programit të studimit në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies janë angazhuar organet drejtuese të fakultetit dhe departamentet përkatëse. Në këtë kuadër, këto njësi organizojnë në mënyrë periodike, leksione të hapura, diskutime, midis stafit më me përvojë dhe stafit të ri. [Evd.113,115,116]
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Angazhimi në ASCAL dhe Bord të Akreditimit konsiderohet nga Universiteti si pjesë e procesit të trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të personelit akademik në fushën e sigurimit të cilësisë. Eksperiencia e fituar ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe fushën e sigurimit të cilësisë.
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Fundit Struktura dhe njësitë bazë nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me lektorë të huaj dhe përditësimit të metodave inovatore të mësimdhënies trajnojnë stafin akademik në implementimin e tyre.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik ka integritet të lartë dhe janë të motivuar në transmetimin e dijeve të studentët duke përditësuar literaturën dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme metodat mësimdhënëse.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në zbatim të strategjisë së UMT-së lidhur me metodat inovative të mësimdhënies, për shkak të dinamikës së shpejtë të zhvillimit teknologjik në fushat e mjekësisë janë integruar një sërë metodash inovative brenda mundësive financiare që siguron institucioni. [Evd. 27, 29] UMT është duke vënë në zbatim pjesën e projektit të Simulimit klinik ku një vend të rëndësishëm zë mësimdhënia me metoda inovative të simulimi virtual, anatomisë 3D, edukimit në distancë etj. [Evd.29]




<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Në sajë të projekteve dhe marrëveshjeve të shumta që UMT ka realizuar lektorë dhe partner ndërkombëtarë [Evd.82] ndajnë eksperiencat e tyre më të mira me stafin akademik dhe jo vetëm nëpërmjet leksioneve të hapura dhe trajnimeve të ndryshme.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” si çdo program që ofrohet në FM dhe UMT, ka të përcaktuar qartë të gjitha veprimtaritë formuese dhe të vlerësimit të njohurive [Evd.58]. Në rregulloren e programit të studimit, në dosjen e programit të studimit, në syllabuset e lëndëve dhe në procedurat e tjera për mbarëvajtjen e procesit mësimor [Evd.61-69], janë të përcaktuara qartë të gjitha aspektet që lidhen me organizimin, zhvillimin dhe vlerësimin e veprimtarive formuese. [Evd.73, 74].</p> <p>Në fillim të çdo lëndë studenti informohet për mënyrën e vlerësimit dhe testimit në këtë lëndë. Bazuar në parime të përgjithshme, vlerësimi i studentit realizohet gjatë gjithë vitit duke e vlerësuar atë për angazhimin e tij gjatë zhvillimit të veprimtarive formuese si dhe në rezultatin e marrë në provimin final të lëndës/modulit. Format e testimit të njohurive janë për aktivizime në seminare, praktika, dorëzim projektsh, detyrash, testime të pjesshme dhe provimi final.</p> <p>Në përputhje me strukturën mësimore studentët në bashkëpunim me pedagogët e lëndës deklarojnë në sekretari datat e provimeve të cilat pasi miratohen në Dekanat shpallen dhe bëhen publike duke përcaktuar datat. Orët dhe sallat ku do të zhvillohen. Pas përfundimit të provimit, pedagogu i lëndës përpilon rezultatet në platformën ESSE3. Rezultatet shpallen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në rregullore. Studenti ka të drejtën e apelimit. [Evd.148].</p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Çdo fillim viti akademik në FM zhvillohet java e informimit me studentët ku atyre iu tregohet një përshkrim i shkurtër i programit, informacion për infrastrukturën në dispozicion, bibliotekën si dhe shërbimet e ndryshme [Evd.91, 92]. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i

	lëndës/modulit.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Në fillim të çdo lëndë studenti informohet për mënyrën e vlerësimit dhe testimin në këtë lëndë. Bazuar në parime të përgjithshme, vlerësimi i studentit realizohet gjatë gjithë vitit dhe me metoda të ndryshme duke e vlerësuar atë për angazhimin e tij gjatë zhvillimit të veprimtarive formuese si dhe në rezultatin e marrë në provimin final të lëndës/modulit. Format e testimin të njohurive janë për aktivizime në seminare, praktika, dorëzim projektsh, detyrash, teste të pjesëshme dhe provimi final. Nga takimi që grupi i ekspertëve të jashtë, patën me studentët, kënaqësia e tyre mbi metodat e vlerësimit të njohurive është garanci për përmbushjen e këtij kriteri.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit duke u vlerësuar në pikë nëpërmjet seminareve, projekteve ose testeve të ndërmjetme të cilat janë të përcaktuara dhe të miratuara në syllabusin e lëndës dhe bëhen pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimin dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMT aplikon dhe përdor metoda të testimin nëpërmjet platformave të ndryshme, p.sh. testimi i pranimit në programet e specializimit afatgjatë që realizohet në bashkëpunim me QSHA duke shfrytëzuar infrastrukturën e këtij institucioni [Evd.56]. GVJ nuk pa evidence tjera për sisteme elektronike të testimin dhe vlerësimit të vazhdueshëm për programin.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi. [Evd.58, 66].
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Në rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë të UMT-së janë përcaktuar procedurat e zhvillimit të provimit dhe kërkesat përkatëse, të cilat janë të shpallura në faqen zyrtare të institucionit [Evd.109]. Njësia bazë, bashkë me njësinë kryesore, harton dhe shpall publikisht kalendarin e provimeve. Titullari i lëndës, në përputhje me kalendarin e shpallur, me fletët e provimit të përgatitura nga sekretaria mësimore (firmosur dhe vulosur nga zv. Dekani), bashkë me fotokopjet e tezave të provimit, të miratuara paraprakisht nga drejtuesi i njësisë bazë, bën verifikimin e studentëve me id-në përkatëse dhe zhvillon procesin e provimit. Sekretaria mësimore, në bashkëpunim me sekretarinë e departamentit, realizon procesin e vendosjes së barkod-it me qëllim

	<p>ruajtjen e anonimatit të studentit gjatë provimit. Pedagogu korrigjon dhe pas çkodimit nga sekretaria mësimore, shpall rezultatet brenda afateve të caktuara kohore.</p> <p>Provimet realizohen me sekretim kur ato zhvillohen me shkrim. Mjediset ku zhvillohen provimet janë të monitoruara me sistem qëndror kamerash si edhe me personel shërbimi që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit të provimeve. [Evd.72].</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ nuk u has me evidence të mjaftuar sa i përket shoqërimit të vlerësimit të njohurive me feedback / komente në mënyrë për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Komisioni i provimeve siguron transparencë maksimale, nuk lejon abuzimin nga studentët, kopjimin apo forma të tjera që deformojnë vlerësimin që çdo student meriton.</p>								
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Shpallja e rezultateve nënkupton procesin ku studenti ka akses në rezultatet personale të provimit, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave. Studenti mund të marrë rezultatin në ditën përkatëse të caktuar nga pedagogu, duke shkuar në sekretari, ose duke u loguar personalisht në sistemin e ri të menaxhimit të të dhënave. Aktualisht është në fuqi një marrëveshje konkrete me Rrjetin Akademik të Shërbimeve (RASH), me të cilin menaxhohen dhe aksesohen të dhënat e rezultateve të studenteve [Evd.51-54].</p>								
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtën e apelimit, proces i cili parashikohet dhe përcaktohet në rregullore. Studenti ka të drejtën edhe të rishikimit të notës. [Evd.148]</p>								
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Studenti ka të drejtën e apelimit (ky proces parashikohet dhe përcaktohet në rregullore). Studenti ka të drejtën edhe të rishikimit të notës. Komisioni i provimeve siguron transparencë të procesit. [Evd.72]</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Përmbajtja e programit të studimit garanton thellimin e njohurive të studentëve</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kurrikula është organizuar në 5 vite akademike dhe ka 35 lëndë relevante ku studenti thellon njohuritë në disa drejtime kryesore të Farmacisë, por edhe zhvillon aftësitë e thelluara profesionale. [Evd.61-68,90]
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Për të zhvilluar më tej aftësitë e përdorimit të teknologjisë programi ka në përmbajtje module të formimit të përgjithshëm, teknologjisë dhe zbatimit të saj në mjekësi, etikës profesionale dhe komunikimit, administrimit të njohurive etj. [Evd.62]
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	GVJ konstaton se ky kriter permbushet plotësisht. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur në përmbajtje të programit të studimit dhe në çdo syllabus. [Evd.64]
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në javën e fundit të lëndës studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik me kohë të plotë integron të reja me të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Departamenti dhe fakulteti vazhdimisht organizojnë leksione dhe seminare të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. [Evd.82,83,113,115]
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Sa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, punët laboratorike zhvillohen në mini grupe me 2 veta duke bërë të mundur që të gjithë të kenë kontakt me praktikën lëndore. Shpesh herë në disa laboratore ata testohen për njohuritë me teste laboratorike
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	GVJ është kondifent se studentet mbështeten sa i përket diskutimeve dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Studentët bashkëpunojnë me pedagogët dhe për çështje të ndryshme, si p.sh. java e ndërgjegjësimit ndaj përdorimit të antibiotikëve, apo aktiviteti për diabetin. [Evd. 95 ,98]
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Departamenti i Farmacisë ka një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore në bashkëpunim me studentët. Në shumë raste stafi akademik publikon, referon apo prezanton bashkë me studentët rezultatet e kërkimeve në aktivitete shkencore. [Evd.111,112]
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Studentet jane mbeshtetur nga stafi i departamenteve të tjera të FM [Dep. i Shëndetit publik, Dep. i Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale] për temat e diplomës si dhe nga disa institucione publike te cilat iu kan ofruar të dhëna apo këshillime për çështje të ndryshme [Evd. 104,132](p.sh. AKBPM, ISHP). Edhe financiarisht




	<p>jane gjetur mundësi mbështetjeje p.sh. vizita në Zvicër. UMT-ja ka arritur të integrojë në fushën kërkimore dhe shkencore edhe studentët, duke i stimuluar për të organizuar dhe realizuar konferencat e tyre. Konkretisht janë realizuar tri Konferenca Mjekësore të Studentëve, në bashkëpunim me qeverinë studentore, organizatat studentore, Urdhrat profesionalë, si dhe në bashkëpunim me universitete të tjera publike dhe jopublike. [Evd.115]</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>GVJ vlereson kete si pike tejet e forte e institucionit dhe programit. Në total janë realizuar 11 marrëveshje me universitete, 6 nga të cilat në nivel ndërkombëtar dhe 5 në nivel kombëtar, të cilat dëshmojnë dhe zhvillojnë partneritetin dhe krijojnë kushte për integrimin institucional. Gjithashtu, UMT-ja ka realizuar, në varësi të fushës bashkëpunuese, edhe 4 marrëveshje me institucione joarsimore, si institute apo qendra kërkimore. [Evd.126]</p> <p>Projektet kërkimore kanë si fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja kërkimore. Në kuadër të projekteve kërkimore të mobilitetit JoinEU-SEE III, ERAWEB I, CEEPUS, në vitet e fundit janë realizuar rreth 91 mobilitete (student dhe staf akademik) drejt universiteteve partnere dhe 12 mobilitete të studentëve të huaj, duke ndihmuar në integrimin e studentëve të huaj në ciklet e studimeve që ofron dhe specifikisht për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” rreth 12 studente si dhe 6 staf akademik</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Në nivel institucional, aktet rregullatore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kanë parashikuar në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit të studentëve [Evd.3, 58]. Edhe Rregullorja e Fakultetit shpreh qartë të gjithë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në FM. Departamenti i Farmacisë ka hartuar dhe miratuar rregulloren specifike të diplomimit, e cila përshkruan procedurat, formatet dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës [Evd.73]. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”, është detyrim ligjor sipas LAL 80/2015 përmbyllja e ciklit të studimeve Master me punim diplome. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit. Temat dhe udhëheqësit miratohen në Asamblenë e Departamentit, pastaj dërgohen</p>

	për miratim në Dekanat, i cili miraton listën e studentëve dhe udhëheqësit shkencorë të cilët do të jenë mbikqyrësit e studentëve deri në mbrojtjen finale të temës së diplomës [Evd.104,105].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Temat dhe udhëheqësit miratohen në Asamblenë e Departamentit, pastaj dërgohen për miratim në Dekanat, i cili miraton listën e studentëve dhe udhëheqësit shkencorë të cilët do të jenë mbikqyrësit e studentëve deri në mbrojtjen finale të temës së diplomës [Evd.104,105]. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. [Evd.74].
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Staf i akademik i fakultetit është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët të cilët kanë në udhëheqje duke vlerësuar performancën dhe progresin e tyre. Këto takime strukturohen në përcaktimin e temës dhe strukturës së punimit, më pas në përpilimin dhe zbatimin e metodës së studimit dhe në fund analizën dhe interpretimin e rezultateve. [Evd.105]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni suporton studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ është konfident se ky kriter përmbushet plotësisht. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Nëse ato janë në përputhje me rezultatet e pritshme, udhëheqësi jep udhëzimet e nevojshme dhe orienton studentit për zhvillimin e mëtejshëm të diplomës. Udhëheqësi garanton shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Vetëm me miratimin e tij studenti mund të dalë për mbrojtje para komisionit të diplomimit. [Evd.16,105]
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë	Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë e cila pasqyrohet në procesverbalin përkatës dhe depozitohet në sekretarinë mësimore. [Evd.105] Studenti dorëzon në Sekretarinë e Fakultetit diplomën e shkruar, kopjen elektronike të saj e cila arkivohet dhe depozitohet në Bibliotekën e Fakultetit
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Në statutin e UMT janë përcaktuar modalitetet e diplomimit, pajisjes me diplomë dhe suplemente të të gjithë studentëve që kanë shlyet të gjitha detyrimet akademike dhe administrative ndaj institucionit [Evd.67,68]. Çdo vit UMT realizon në nivel universiteti






ministria përgjegjëse për arsimin.	Ceremoninë e diplomimit dhe pajisjes me diplomë të studentëve. <a href="http://umed.edu.al/">http://umed.edu.al/</a> . Diploma është dokument unik që mbart të gjithë elementët e përcaktuar dhe miratuar nga MASR dhe lëshohet vetëm njëherë. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajisjet vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj. [Evd.67,68]			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hardcopy si dhe në databazën digjitale që tashmë disponon UMT, sistemi ESSE3 [Evd.109,131]			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen	Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen, pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas dorëzohen në Arkivën e Shtetit Shqiptar: [Evd.100] - Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matrikullimi deri në marrjen e diplomës ose certifikatës; - Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik; - Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emetimin e certifikatave dhe diplomave Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. [Evd.100]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. I gjithë dokumentacioni i çdo punonjësi ruhet në arkivën e Sektorit të Burimeve Njerëzore. Dosjet e personelit përditësohen vazhdimisht me aktivitete të reja të stafit, rezultate të kërkimit apo botime shkencore.

  
Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.				
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Organizimi, rekrutimi i stafit akademik dhe administrativ realizohet në varësi të nevojave të njëjësive kryesore, të departamenteve në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UMT [Evd.1,3]. Në fillim të çdo viti akademik, Rektorati merr në shqyrtim propozimet e fakulteteve të sjella nga departamentet dhe ia paraqit ato në formën e një draft-propozimi Senatit Akademik. Në përfundim të procesit, struktura e plotë bëhet publike në faqen elektronike zyrtare. [Evd.35]			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës-akademik, UMT-ja ndjek politika të përcaktuara saktë në aktet përkatëse rregullative. Konkretisht, procedura e rekrutimit nis me shpalljen e konkursit dhe publikimin e vendit/eve vakante me kriteret e përgjithshme dhe specifike në faqen zyrtare të Prokurimeve Publike dhe të UMT-së [Evd.79]. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara kryesisht në Statutin dhe Rregulloren e UMT, kurse kriteret specifike që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik dhe ndihmës mësimitor-shkencor, propozohen nga departamenti përkatës në përputhje me nivelin dhe fushën e lëndëve të programit të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	FM në përputhje me afatet kohore ngre komisionet ad-hoc të vlerësimit me 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të Departamentit përkatës, një përfaqësues i Dekanatit dhe një përfaqësues i Rektoratit [Evd.36-42]. Komisioni bën vlerësimin e aplikantëve në përputhje me kriteret e shpallura, shqyrton dosjen e aplikimit sipas formularit të vlerësimit dhe harton listën e kandidaturave, sipas pikëve të grumbulluara, në rendin zbritës për çdo kandidat së bashku me pikët e intervistës. Kandidatët njoftohen nga NJSBC me email për pikët e grumbulluara dhe rankimin e tyre. Pas përfundimit të afatit të ankimit [Evd.41], shpallet lista përfundimtare e kandidatëve fitues nga Dekani, i cili përcjell tek Rektori emrat fitues, së bashku me renditjen e tyre. GVJ bëri pyetje specifike rreth sigurimit të mundësisë të barabartë dhe diversitetit në proces të rekrutimit të personelit dhe nuk mori përgjigje adekuate. <i>Edhe pse nuk është kriter specifik, GVJ rekomandon konsiderim në këtë aspekt për të ardhmen.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

**Standardi IV.2****Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin**


<b>e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	UMT ka në strategjinë e zhvillimit të tij politika të qarta për krijimin e mundësive të barabarta e të përshtatshme për kryerjen sa më optimale të detyrave akademike. [Evd.17,50]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Kualifikimi dhe zhvillimi profesional i stafit të UMT-së me qëllim përvetësimin e praktikave më të mira akademike dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare, konsiston në disa drejtime: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ofrimin e leksioneve të hapura me lektorë të huaj dhe personalitete të fushave mjekësore specifike</li> <li>- Ofrimin e trajnimeve nga shërbimet spitalore lidhur me metodat inovative në specialitetet përkatëse</li> <li>- Ofrimin e edukimit në vazhdim falas për të gjithë stafin</li> <li>- Programet e mobilitetit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në kuadër të programeve ndërkombëtare</li> <li>- Aktivitete shkencore të përbashkëta me institucione të huaja dhe vendase</li> <li>- Aktivitete kualifikuese me AKKSH për mundësitë dhe informacionin e aplikimeve në projekte kërkimore</li> <li>- Kualifikime teknike për përdorimin e platformës të menaxhimit të programit të studimit nga RASH (ESSE3)</li> <li>- Kualifikime për përdorimin e bibliotekës on-line</li> <li>- Kualifikime të stafit akademik të ri nëpërmjet tutorimit nga stafi akademik me eksperiencë</li> <li>- Mbështetje të iniciativave personale në aktivitetet e kualifikimeve profesionale dhe të mësimdhënies</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.	Në zbatim të strategjisë së UMT-së lidhur me metodat inovative të mësimdhënies janë integruar një sërë metodash inovative brenda mundësive financiare që siguron institucioni [Evd.27,29]. Gjithashtu, një projekt konkret ambicioz lidhur me futjen e teknologjive të reja në procesin e mësimdhënies është ngritja e qendrës së simulimit klinik për të cilën është aplikuar në disa burime të mundshme financiare. [Evd.119]
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit menaxhon dhe drejton në përputhje me kuadrin ligjor dhe me aktet rregullative menaxhimin e stafit akademik dhe stafit ndihmës duke ndarë përgjegjësitë dhe detyrat në mënyrë sa më optimale [Evd.114,154]. Njësia bazë angazhohet që stafi akademik të plotësojë detyrimet ligjore në lidhje me ngarkesën mësimore, institucionale dhe atë kërkimore duke mbledhur në fillim të çdo viti akademik parashikimin e orëve të ngarkesës mësimore për secilën veprimtari dhe në fund të çdo viti akademik formularin e realizimit të detyrimeve ligjore dhe detyrave të përcaktuara shtesë. Departamenti, të dhënat e mbledhura i bën pjesë të raportit vjetor me analizën përkatëse si dhe me plan masat përkatëse. [Evd.85].



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. UMT-ja kryen dhe zhvillon veprimtarinë akademike dhe administrative në 9 godina, të cilat janë në pronësi të institucionit dhe menaxhohen prej tij [Evd.123, 124]. Asetet infrastrukturore administrohen dhe menaxhohen nga Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve, kancelari i institucionit dhe Bordi Administrativ. Drejtoria e Buxhetit dhe Investimit është struktura që disponon inventaret e aseteve të institucionit, si dhe planifikon dhe realizon, në përputhje me buxhetin e miratuar, sipas udhëzimeve përkatëse, shtimin dhe përmirësimin e tyre, sipas zërave konkretë.</p> <p>Institucioni, disponon 14958 m<sup>2</sup> në funksion të procesit mësimor dhe 5000 m<sup>2</sup> në funksion të veprimtarisë administrative, duke përfshirë auditore, klasa, laboratore, mjedise për stafin akademik, salla mbledhjeje, salla kompjuterësh etj., si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Godina qendrore përfshin: 2 auditorë me kapacitet 70 dhe 100 vende uljeje, 15 zyra administrative.</li> <li>2. Godina e Lëndëve Paraklinike përfshin 2 auditorë leksionesh me kapacitet 200 vende uljeje, 22 salla seminari me 30 vende uljeje, 5 laboratore me 20 vende uljeje, si dhe 31 zyra administrative.</li> <li>3. Godina e Anatomisë përfshin 2 auditorë, me kapacitet 150 vende uljeje, 2 salla seminari me 30 vende uljeje, 5 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 9 zyra administrative.</li> <li>4. Godina e Mjekut të familjes përfshin 1 auditor me kapacitet 150 vende uljeje, 2 salla seminari me 30 vende uljeje, si dhe 2 zyra administrative.</li> <li>5. Godina Galileo Galilei përfshin 1 auditor me kapacitet 150 vende uljeje, si dhe 3 zyra administrative.</li> <li>6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit publik përfshin 1 auditor me kapacitet 100 vende uljeje, 5 salla seminari me 30 vende uljeje, 13 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 20 zyra administrative.</li> <li>7. Godina 1 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 6 auditorë me kapacitet 70 deri 200 vende uljeje, 10 salla seminari me 50 vende uljeje, 6 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.</li> <li>8. Godina 2 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 4 auditorë me kapacitet 120-150 vende uljeje, 14 salla seminari me 50</li> </ol>




	<p>vende uljeje, 3 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 21 zyra administrative.</p> <p>9. Godina e Mjekësisë Dentare përfshin 2 auditorë me kapacitet 200 vende ulje, 3 salla seminari me 30 vende uljeje, 15 laboratorë me 25 vende ulje, si dhe 14 zyra administrative</p> <p>Institucioni poashtu ka në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor-shkencor, spitalor e klinik dhe asetet e strukturave shëndetësore universitare, që në totalin e tyre janë rreth 115,500 m<sup>2</sup> [Evd.50]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UMT disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij. Ambientet e fakulteteve (salla leksionesh e seminaresh, laboratorë didaktikë mësimorë) dhe të spitaleve universitare (salla seminaresh, laboratorë mjekësorë kërkimorë-shkencorë dhe kabinete diagnostikuese dhe kuruese) janë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor-shkencor për studentët dhe personelin akademik. Sipërfaqet në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në nivel programi studimi të gjithë laboratorët ku zhvillohen orët laboratorike janë të pajisur dhe plotësuar me mjete mësimore, aparatura dhe reagentë në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. [Evd.161]</p> <p>1. <b>Godina e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” (2 kate)</b></p> <p>Godina në funksion të programit përbëhet nga 2 kate, ku secila prej tyre ka laboratorët si më poshtë: Kati III - Ka në total 4 laboratorë, 2 preparatorë, 8 zyra (2 për stafin administrativ dhe 6 për stafin akademik) Lab. i Analizës së Drogave, Lab. i Përgatitjes Galenike, Lab. i Përgatitjeve kozmetike, Lab. i Kimisë Toksikologjike. Kati IV - Ka në total 5 laboratorë (4 mësimorë dhe 1 kërkimor), 2 preparatorë si dhe 3 zyra në funksion të stafit akademik. Lab. i Analizës Farmaceutike, Lab. i Kimisë Analitike, Lab. i Kimisë inorganike, Lab. i Kimisë Organike. [Evd.161]</p> <p>2. <b>Ambientet e strukturave shëndetësore universitare</b> (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë), të cilat përfshijnë të gjitha sallat mësimore, bibliotekat etj. Në këtë infrastrukturë ofrohen një sërë laboratorësh në funksion të programit të studimit:</p> <p>- Lab. i Farmakologjisë, Lab. i Anatomisë, Lab. i Mikrobiologjisë, Lab. i Biokimisë, Lab. i Histologjisë, Lab. i Fiziologjisë, Lab. i Simulimit klinik, Lab. i Informatikës etj.</p> <p>3. <b>Godina qendrore e FM</b>, ku kryesisht është e vendosur sekretaria mësimore në funksion të programit të studimit, si dhe administrative në nivel të njësisë kryesore.</p> <p>Gjithashtu, infrastruktura perbehet edhe nga ambiente zyresh per stafin</p>




	administrativ, ambiente zyrash per shefat e departamenteve, ambiente zyrash per sekretarine mesimore, salla biblioteke, etj. [Evd.90]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ambientet e strukturave shëndetësore universitare (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë) ofrohen një sërë laboratorësh në funksion të programit të studimit duke përfshirë Lab. i Simulimit klinik dhe Lab. i Informatikës. Janë në përdorim për studentët 6 salla informatike me një kapacitet prej 176 kompjuterash. [Evd.125]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Duke u bazuar ne evidencen ne dispozicion, GVJ konkludon se mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën qendrore ku gjenden një numër vëllimesh prej 53000 libra dhe revista shkencore 18000 koleksione dhe garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Ne bibliotekën qendrore u gjenden një numër vëllimesh prej 53000 libra dhe revista shkencore 18000 koleksione. Biblioteka qendrore kryen dixhitalizimin e skedarëve, si dhe shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit. Fondi i bibliotekës mbulon kryesisht fushat e shkencave mjekësore, të shëndetit publik, stomatologjike, farmaceutike dhe të shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Gjithashtu, kjo bibliotekë ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës.  Të njëjtën mënyrë funksionimi ndjekin edhe bibliotekat në tri fakultetet e UMT-së, të cilat janë nën varësinë e bibliotekës qendrore. Ato disponojnë kryesisht literaturë mësimore bazë dhe ndihmëse [Evd.125, 126], si dhe literaturë shkencore të fushave përkatëse sipas fakultetit.  Në lidhje me programin e studimit “Master i Shkencave” në



Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

	"Farmaci", e gjithë literatura e detyruar dhe ndihmëse është e depozituar në bibliotekën e Fakultetit të Mjekësisë duke duke u krijuar mundësi studentëve të studiojnë dhe të përdorin literaturën pranë bibliotekës. Ky arkiv shpesh herë rifreskohet si rezultat edhe i donacioneve.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Të gjithë studentet kanë akses të plotë në bibliotekën onile, ky akses ju jepet që në monetin e parë që ata janë studente. Studentët pervec bibliotekës onilen që ka blerë dhe venë në dispozicion MASR kanë edhe bibliotekën onile te UMT, ku kanë akses të plotë studente dhe stafi akademik.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Cdo vit parashikohet IAL parashikon një buxhe të caktuar për blerjen e libra dhe pasurimin e bibliotekekës. Kërkesar nisin nga departamentet për botimet e reja, revista etj. Vitin e kaluar pasurimi me libra rezultoni edhe nga donacione të librave.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka kishte orare shumë të përshtatshme për studentet. Oraret ishin të afishuara në bibliotekë. Gjatë periudhës së sezonit të provimeve, studentet kanë mundësi akses në bibliotekë edhe ditën e shtunë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Pa përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMT, nëpërmjet implementimit të shërbimeve të integruara të informacionit në arsimin e lartë, ka aktualisht në përdorim dy sisteme të rëndësishme të ruajtjes dhe përpunimit të informacionit elektronik: 1. Institucioni është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar [RASH], ku me anën e moduleve të sistemit të bazës së të dhënave ESSE3, përpunohen të dhënat dhe përcillet informacion në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe në rrjetin e institucioneve të arsimit të lartë të menaxhuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar. Nëpërmjet bashkëpunimit me QSHA,

	<p>institucioni realizon procesin e aplikimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UMT-së, matrikullimin e studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UMT-ja, menaxhon dhe monitoron procesin e provimit të shtetit ose licencimit, si dhe procesin e konkurrimit nëpërmjet testimit të kandidatëve për programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë. Po ashtu, koordinohen të dhënat e studentëve aktualë dhe të rinj për krijimin e regjistrit elektronik themeltar, sipas udhëzimeve të MASR, ose përditësohen numrat e matrikullimit në bazën e të dhënave së agjencisë së provimeve. Nëpërmjet ESSE3 ofrohen funksionalitete të nevojshme për sekretarinë mësimore, kërkimin shkencor, menaxhimin financiar, etj. [Evd.51-54]</p> <p>2. UMT ka llogari të posaçme dhe përdor shërbimet e ASCAL Management System [AMS] nëpërmjet të cilit UMT-ja administron dhe menaxhon të gjithë informacionin elektronik dhe arkivën elektronike që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, administrative dhe shërbimeve, programet e studimit dhe të dhënat e detajuara për to, studentët aktivë që ndjekin studimet, stafin akademik në kohë reale, fushën e studimit, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale. Nëpërmjet këtij sistemi, UMT-ja aplikon për shërbime të ndryshme të kryera nga ASCAL-i dhe, po ashtu, raporton në mënyrë të vazhdueshme në ASCAL në lidhje me aktivitete të zyrës së sigurimit të cilësisë apo raportime në lidhje me procese të vlerësimit që janë në zhvillim në UMT. Një nga dokumentet më të rëndësishme të prodhuara nga ky sistem dhe që është në shërbim të institucionit dhe në funksion të këtij procesi, është General Institutional Data [ref. 44], të cilin institucioni mund ta gjenerojë në çdo moment kur kërkohen të dhëna apo raportime statistikore nga ASCAL-i ose MASR. [Evd.24]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nëpërmjet ESSE3 FM disponon të gjitha të dhënat e personelit akademik. [Evd.51]</p> <p>Institucioni, në zbatim të projektit me RASH-in, realizon menaxhimin e ciklit akademik të studentit: regjistrimin, vlerësimet e studentit deri në diplomim, transferimin e studimeve të studentit, pagesat etj</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet ESSE3 FM disponon të gjitha të dhënat e personelit akademik dhe studentëve të cilat përditësohen nga profili individual i përdoruesit. Sistemi mundëson ndjekjen në kohë të ecuresë së studentëve pasi në të regjistrohen notat e marra në të gjitha lëndët/modulet, frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të paracaktuara në çdo lëndë/modul [Evd.52]. Vetë departamentet janë në gjendje në çdo kohë të analizojnë të dhënat e studentëve nëpërmjet regjistrit “hardcopy” që sekretaria mësimore mban, si edhe të analizojë të dhënat e gjeneruara nga sistemi ESSE3. Aksesit në FM-UMT-ESSE3 është i autorizuar dhe i monitoruar. Çdo</p>






	informacion në sistem konsiderohet i klasifikuar dhe çdo ndërhyrje në të për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në profilin e çdo përdoruesi, dënohen sipas përcaktimeve ligjore. [Evd.51, 52]			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Stafi akademik përveç komunikimit me e-mail dhe grupeve mësimore, përdor dhe platforma të edukimit si google education etj, me anën e të cilave shkëmbehen informacione dhe materiale me studentët.  Aktualisht po mundësohet futja e platformës Moodle për stafin dhe studentët e FM. Në këtë kuadër janë planifikuar trajnime dhe takime lidhur me funksionalitetin e kësaj platforme. [Evd.57]			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	UMT ka llogari të posaçme dhe përdor shërbimet e ASCAL Management System [AMS] nëpërmjet të cilit UMT-ja administron dhe menaxhon të gjithë informacionin elektronik dhe arkivën elektronike që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, administrative dhe shërbimeve, programet e studimit dhe të dhënat e detajuara për to, studentët aktivë që ndjekin studimet, stafin akademik në kohë reale, fushën e studimit, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale. [Evd.24].			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Ne shqim te ëeb faqes te Fakultetit, si duket ky kriter permbushet pjeserisht sepse vetem nje pjese e struktures / skeletit te ëeb faqes eshte publikuar ne gjuhen angleze kurse informacionet specifike jane vetem ne gjuhen shqipe.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në UMT, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, realizohet sipas skemave dhe formateve të përcaktuara nga institucionet qeveritare, bazuar në programin buxhetor të shtetit.  Në hartimin e buxhetit merren parasysh granti përkatës i gjeneruar nga MASR, si dhe të gjitha të ardhurat që gjeneron institucioni nga studentët, shërbimet, projektet etj. Politikat e shpërndarjes së burimeve financiare dhe përdorimi i tyre kryhet në përputhje me LAL, Ligji 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.  Procesi i hartimit të Projekti i Buxhetit Afatmesëm (PBA-së) nis me

diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë konkretisht nga Departamenti i Farmacisë ku specifikohen zërat e të gjithë shpenzimeve dhe investimeve në përputhje me zhvillimin dhe realizimin me sukses të procesit mësimor, kërkimor dhe administrativ. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, Njësia Kryesore (fakulteti) përcjell PBA-në në nivel fakulteti në Rektorat.

Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve përpilon dokumentin përmbledhës dhe, së bashku me një relacion të hollësishëm, duke argumentuar zërat e parashikuara në PBA, nëpërmjet kancelarit të institucionit, dokumenti i përcillet Senatit Akademik për shqyrtim dhe miratim.

Senati Akademik shqyrton projekt-buxhetin e paraqitur dhe e miraton atë nëse është në përputhje me politikën e zhvillimit të institucionit, PS-në, programin vjetor të veprimtarive të nxitjes së kërkimit shkencor dhe misionit të UMT.

Bordi i Administrimit është organi kolegjal i cili merr në shqyrtim PBA-në, pas miratimit nga Senati Akademik. Bordi i Administrimit miraton përfundimisht PBA-në, pasi vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe rezultatet e pritshme. [Evd.149]

Në bazë të legjisllacionit për arsimin e lartë, BA është organi kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtarinë e institucionit të arsimit të lartë, që lidhet me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të aseteve të tij. Kancelari ose administratori sipas këtij ligji, është autoriteti drejtues i cili është pjesë e strukturave ekzekutive dhe përgjegjës për zbatimin e politikës financiare; drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. [Evd.150]

Struktura të tjera mbështetëse në funksion të menaxhimit financiar janë: Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve, Njësia e Auditit, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme.

Procedura që ndiqet për hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor bazohet në takimet periodike me organet drejtuese të universitetit (Rektorat, Senat Akademik, Bord Administrimi), me qëllim njohjen me ecurinë e zbatimit të buxhetit dhe transparencën në veçanti të zërave analitikë buxhetorë. Diskutime dhe analiza të punës kryhen me pjesëmarrje të gjerë të stafit akademik dhe studentëve.

Institucioni, veprimtarinë e tij financiare e realizon në mbështetje dhe zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", LAL 80/2015 dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për zbatimin e buxhetit, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, UMT-ja ka sektorin e Financës, ndjek në kohë reale

	<p>ecurinë e implementimit duke mundësuar në këtë mënyrë edhe raportime financiare pranë drejtuesve të institucionit, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në Ministrinë e Financave.</p> <p>Në UMT, regjistrimet kontabël bëhen sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit; Ligji nr. 9477, datë, 08.03.2006, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>UMT i menaxhon shpenzimet dhe të ardhurat si në nivel Rektorati, ashtu dhe në nivel Fakulteti, sipas përcaktimeve në aktet normative në fuqi. Kjo ndikon në mirëmenaxhimin financiar, pasi kërkesat e të gjitha departamenteve pasqyrohen, grupohen dhe prokurohen sipas kërkesave dhe nevojave të secilës njësi shpenzuese.</p> <p>Te ardhurat vjetore dhe shperndarja e tyre ndryshojne nga viti ne vit; per vitin aktual, t€ ardhurat dhe shpenzimet sipas zerave kryesore ne UMT jane dhene ne General Information Data [Evd. 137,138]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin në fuqi, institucioni i nënshtrohet auditëve financiare, që realizohen nga institucionet e parashikuara me ligj për këtë qëllim. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre, realizohen nga njësitë e auditit të brendshëm të MASR, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) dhe nga MF. Siç është cituar dhe më lart, njësia e brendshme e auditit kryen kontrole/auditime periodike bazuar në një program vjetor pune, dhe shprehet nëpërmjet raporteve përkatëse për gjetjet dhe rekomandimet në njësinë e audituar.</p> <p>Në përfundim të angazhimit, grupi i auditimit harton Raportin e auditimit, në të cilin paraqiten rezultatet paraprake të auditimit të kryer në institucion dhe i vihet në dispozicion titullarit të tij [Evd.150,45]. Raporti i auditit financiar analizohet nga organet drejtuese të UMT-së, i cili evidenton problematikat e politikave e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentë. Përsa i përket publikimit të raporteve të auditimit, vetëm raporti i auditues i KLSH-së bëhet publik, ndërsa raportet e organeve të tjera audituese bëhen objekt shqyrtimi dhe analize të Bordit të administrimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon aksione adekuate për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij [Evd.84].</p>



të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Suksesi i vazhdueshëm në menaxhimin, drejtimin dhe diplomimin tregon për një qëndrueshmëri institucionale dhe financiare.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ është konfident se ky kriter përmbushet plotësisht. Pranimet në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë administrohen në bashkëpunim me MASR dhe institucionet përgjegjëse për administrimin e pranimit në IAL. UMT është përgjegjëse për përcaktimin e kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe për këtë qëllim ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatorë [Evd.1,3]. Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit, procedurën e pranimeve në vitin akademik dhe Udhëzimet që nxjerr MASR [Evd.38,39,40-42]
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë. UMT nëpërmjet komisioneve ad-hoc të përbëra me përfaqësues nga çdo fakultet dhe sistemeve informatike që përdor, ka zhvilluar procedurat më të drejta të përzgjedhjes së studentëve të rinj. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në disa komponentë duke përfshirë rezultatet e maturës shtetërore, rezultatet e shkollës së mesme, rezultate në grup lëndët e shkencave natyrore, llojin e shkollës së mesme. [Evd.37-41]
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së	Kriteret specifike të pranimit dhe numri i kuotave në programin e studimit

<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>“Master i Shkencave” në “Farmaci” propozohen nga Departamenti i Farmacisë dhe miratohen nga Dekanati i FM [Evd.140]. Numri i kuotave çdo vit propozohet nga asambleja e departamentit në përputhje me kapacitetet, miratohet nga Senati i UMT-së dhe më pas certifikohet nga MASR [Evd.38,40]. I gjithë informacioni i mësipërm, bëhet publik në faqen zyrtare të UMT veçanërisht kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi. [Evd.41]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Institucioni e kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar në të si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b><u>Ditët e Informimit</u></b> - Informimi i maturantëve organizohet nga MASR në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave të mesme gjatë të cilit grupe pune në nivel institucional sipas një kalendari të caktuar informojnë maturantët për programet e studimit që ofrojnë dhe kriteret përkatëse. [Evd.89]</li> <li>2. <b><u>Panari i punës</u></b> – Një organizim përsëri i rregulluar nga MASR ku të gjithë universitetet në stendat e tyre ofrojnë informacionin e duhur për programet që ofrojnë për të gjithë publikun e interesuar</li> <li>3. <b><u>Dita e bluzave të bardha</u></b> - Në fillim të çdo viti akademik, fakultetet në bashkëpunim me KS dhe sektorin e komunikimit organizojnë për studentët e rinj aktivitete informuese ku studentëve u dhurohet bluza e bardhë dhe bëhet një prezantim rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi kontaktet e nevojshme. Ky takim vijohet nga KSFM, ku studentë të viteve të larta shoqërojnë studentët e sapoardhur për tu njohur me të gjitha ambientet fizike të fakultetit apo të universitetit. Në fakultet ndodhen zyrat e informacionit, sekretaria mësimore të cilat janë në dispozicion të studentëve. [Evd.89,91]</li> <li>4. <b><u>Një ditë student</u></b>- FM organizon me maturantët e interesuar një ditë të hapur mësimi me qëllim që ata të shohin nga afër procesin dhe infrastrukturën.</li> <li>5. <b><u>Katalogu i studentit</u></b> – Vitet e fundit fakulteti publikon katalogun e studentit i cili përmbledh të gjithë informacionin e nevojshëm që duhet të ketë studentit në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në FM. [Evd.90]</li> <li>6. <b><u>KSFM</u></b> - Studentët mund të marrin informacion edhe nga strukturat e tyre, KSFM, senatorët e klasave, zyra e karrierës, përfaqësuesit e tyre në organet drejtuese të universitetit etj. [Evd.120-122] [Evd.14,87]</li> <li>7. Çdo vit akademik departamenti miraton deri në 10 kuota për studentët e shteteve si Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni etj. por me kombësi shqiptare.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. UMT ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me njërin prind invalid, duke parashikuar kuota pranimi në</p>

margjinalizuara.	<p>programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100%. [Evd.127] [Evd.129,130]</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës në funksion të studentëve me aftësi të kufizuara është një sfidë për UMT në tërësi dhe FM në veçanti. Fakulteti ka në proces hartimin e planprojektit të plotësimit të të gjitha godinave me rampa në funksion të kësaj kategorie studentësh [Evd.45]</p>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kriteret e përzgjedhjes së studentëve huaj janë të njëjta si studentët shqiptarë por deri tani nuk është aplikuar ndonjë procedurë rekrutimi e studentëve të huaj (përfshirë studentët me kombësi shqiptare).			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. UMT ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me njërin prind invalid, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100%. [Evd.127] [Evd.129,130].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullative institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në web-in e FM dhe UMT. Gjithashtu, organizmat e këshillave studentorë [Evd.121] shërbejnë për informimin e studentëve apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara e të bëra publike. [Evd.36]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në lidhje me mënyrën e vlerësimit studentët informohen në orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi. [Evd.134,135]
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në	Institucioni publikon informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së diplomimit, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj.



programin e studimit.	[Evd.73 ]. FM organizon edhe trajnime të hapura në lidhje me shkrimin dhe prezantimin e temës së diplomës.		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	FM dhe Departamenti i Farmacisë mbështet KSFM në organizimin e takimeve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm duke dhënë eksperiencat e tyre personale në formë diskutimi me studentët e rinj. [Evd.120]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton se ky kiter përmbushet plotësisht. Studentet informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit. [Evd.61]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Përveç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të lëndës.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Dosja e programit të studimit paraqet një informacion të hollësishëm për të gjitha aspektet duke përfshirë edhe punësimin [Evd.36]. Në nivel fakulteti apo universiteti, studentët informohen për çdo aspekt për të cilin ata janë të interesuar si p.sh. mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se ky kiter përmbushet plotësisht. Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative [Evd.90, 123] të cilat janë të publikuara në formë dixhitale, në dispozicion të studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton se ky kiter përmbushet plotësisht. Në nivel programi studimi është ngritur dhe funksionon tutoriati ku për çdo kurs studimi është caktuar një pedagog i departamentit për ti asistuar studentët në problematika të ndryshme por dhe për ti informuar në lidhje me aktet rregullative dhe elemente të detajuar të programit të studimit. [Evd.66]
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe	Gjatë semestrit, secili pedagog administron regjistrin e pedagogut që është një dokument zyrtar ku evidentohet aktiviteti i përjavshëm i

aktivitetin mësimor të studentëve	<p>pedagogut, renditjen e temave, mungesat e studentëve, vlerësimi i tij gjatë realizimit të seminareve dhe leksioneve etj.</p> <p>Në fund të semestrit secili pedagog depoziton në Departament listën me emrat e plotë të studentëve me performancën e tyre në lidhje me frekuentim dhe vlerësimin gjatë vitit. Në fund të semestrit që përkon me përfundimin e lëndës, çdo pedagog realizon plotësimin e regjistrimit tip.</p> <p>Në zbatim të rregullores së Departamentit për programin e studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" secili pedagog ka detyrimin e ruajtjes së tezave apo fletoreve të provimit për një periudhë deri në sesionin e provimeve pasardhëse. Në funksion të mirëmenaxhimit efektiv janë tabletat që luajnë rolin e regjistrimit [Evd.99,119]</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UMT si çdo institucion publik në RSH ka detyrim ligjor të administrojë, ruajë dhe arkivojë çdo dokument dhe informacion zyrtar që lidhet me aktivitetin e vet [Evd.1,3]. Në UMT arkiva themelore përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive mësimore të secilit fakultet. [Evd.100] Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin e diplomave të lëshuara.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin e regjistrimeve për çdo program studimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Në UMT arkiva themelore përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive mësimore të secilit fakultet. [Evd.100]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të</p>	<p>Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës [Evd.131]. I</p>





<p>verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Ky informacion është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim apo zotërimit të një account-i nga studenti, për të dhënat e tij për sa kohë studenti është i regjistruar. Ky i fundit përmes numrit të matriculimit mund të shikojë vetëm ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për këtë. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit nga sekretaria mësimore dhe çdo veprim mbi to është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar. Sistemi regjistron automatikisht çdo editim, ndërhyrje, kohën e ndryshimit dhe llogarinë nga ka ardhur ndryshimi.</p> <p>Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe. Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme.</p> <p>Aksesi në FM-UMT-ESSE3 është i autorizuar dhe i monitoruar. Çdo informacion në sistem konsiderohet i klasifikuar dhe çdo ndërhyrje në të për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në profilin e çdo përdoruesi, dënohen sipas përcaktimeve ligjore [Evd.51,52].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (p.sh. rreth 50 % e studentëve e kanë ruajtur notën mesatare për grup lëndët e analizuar krahasuar me mesataren e përgjithshme të shkollës së mesme), si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. [Evd.84,85]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>NO</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret 1-2 të standardit V.5 përmbushen plotësisht. Përfaqësimi i studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UMT është garantuar në Statut dhe aktet rregullatore të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Dekanatin e Fakultetit të Mjekësisë, në komisionet ad-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi [Evd.14].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshilli studentor i UMT (KSUMT) dhe Këshillat e Fakulteteve (në rastin konkret KSFM) janë organe kolegjiale përfaqësuesit e të cilave janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

	institucional me këto organe përveçse një detyrim ligjor është edhe një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve.		
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Ndër strukturat pjesë e UMT në përmirësimin e programit të studimit janë edhe <i>Studentët aktualë</i> në programin e studimit, të cilët japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e studimit. Ata janë të organizuar me përfaqësuesit e tyre “senator” në nivel kursor por edhe në nivel programi studimi të cilët nëpërmjet Këshillit Studentor të FM mund të përcjellin mendimet e tyre jo vetëm në Dekanat, por edhe në hallkën më të lartë të miratimit të planeve mësimore – Senatit Akademik – ku njëri prej anëtarëve është përfaqësues nga studentët. [Evd.14,122]		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Nëpërmjet KSFM, studentët japin mendime për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifat e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikat, sezonet e provimeve etj. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimin të metodologjisë së mësimdhënies në programin e studimit është i vazhdueshëm dhe bazohet në bashkëpunimin student-pedagog.		
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. FM ka të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit. Çdo provim parashikon edhe ditën e dhënies së rezultatit individualisht ku studenti ka të drejtën edhe të ankimimit. [Evd.148]		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>


<b>Standardi V.6</b>	
<b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Personeli akademik është i angazhuar në pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare [Evd.84,107], edhe pse rekomandohet që në të ardhmen këto pjesëmarrje të rriten ose cilësia e konferencave ndërkombëtare të jetë më e lartë dhe personeli suportohet për pjesëmarrje.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	GVJ konkludon se kjo është një nga piket e forta të aktiviteteve të institucionit. FM ka rritur mundësitë e bashkëpunimeve me institucione partnere, brenda dhe jashtë vendit. Qëllimi ka qenë jo vetëm ndërkombëtarizimi i aktivitetit kërkimor-shkencor në nivel fakulteti por edhe krijimi i mundësive për të përfituar nga rezultatet

	e projekteve me qëllim përmirësimin e procesit mësimor, kërkimor dhe infrastrukturor të fakultetit dhe universiteti në tërësi. [Evd.107] Lista e partnerëve dhe bashkëpunëtorëve ka krijuar mundësi të reja të bashkëpunimit nga të cilat kanë përfituar jo vetëm personeli akademik, por dhe studentët e programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.	Kriteri përmbushet. Stafit akademik publikon, referon apo prezanton bashkë me studentët rezultatet e kërkimeve në aktivitete shkencore. [Evd.111,112]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Produktiviteti shkencor i stafit akademik, të angazhuar me kohë të plotë si pjesë e Departamentit të Farmacisë është individual dhe i variushëm, ndërkohë për një pjesë ky produktivitet është i lartë në numër artikujsh shkencorë dhe citimesh për një pjesë konstatohet se ky produktivitet është i ulët prej mungesës së botimeve shkencore në revista të rankuara sipas Scopus, PubMed, web of Science, në 5 vitet e fundit [Evd.107]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Perderisa GVJ ka confidence në motivimin dhe mbështetjen e studentët nga se institucioni dhe personeli akademik të angazhohen në studime interesante dhe relevante, aktiviteti rreth kërkimeve inovuese dhe patentave nuk është i dukshëm.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Studentët suportohen në kërkimit shkencor. Stafit akademik i fakultetit është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët të cilët kanë në udhëheqje duke vlerësuar performancën dhe progresin e tyre. Këto takime strukturohen në përcaktimin e temës dhe strukturës së punimit, më pas në përpilimin dhe zbatimin e metodës së studimit dhe në fund analizën dhe interpretimin e rezultateve. Stafit akademik ka mbështetur gjithashtu edhe në kryerjen e analizave specifike në bashkëpunim me institucione të tjera. [Evd.105]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.7</b> <b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Bashkëpunimet në nivel universiteti dhe marrëveshjet që FM ka nënshkruar kanë mundësuar ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të personelit akademik dhe fakultetit në tërësi. FM ka qenë mjaft aktiv në krijimin e lidhjeve për të mundësuar shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve. Është e dukshme se angazhimi në këte aspekt ka qenë maksimal dhe impakti që kanë sjellë është i dukshëm në implementimin e metodave të kërkimit nga personeli akademik

	dhe studentët. [Evd.84,107]			
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Programit të studimit në përmbajtjen aktuale përputhet me programe që zhvillohen në disa institucione evropiane dhe garanton vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve, specializime afatgjatë dhe doktoraturë. Fakti që një numër i lartë diplomantësh vazhdojnë studimet në ciklin e tretë në universitete perëndimore tregon se ky program përgatit në nivele cilësore studentët për cikle me njohuri të thelluara.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.	GVJ konstaton se kriteret 3-5 të standartit V.7 përmbushen plotësisht. Departamenti ka shërbyer për shumë vite si ofrues i ciklit të tretë jo vetëm për studentët e vet, por dhe ata të ardhur nga troje shqipfolëse (Kosova, Maqedonia, Mali i zi etj). [Evd.85]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Politikat e kërkimit të Institucionit janë konceptuar për të qenë gjithëpërfshirëse dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e studiuesve të rinj. Kjo formë bashkëpunimi ka favorizuar angazhimin e personelit të ri në aktivitete kërkimore [Evd.34] si dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në studime dhe në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. [Evd.111,112]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.				
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	FM, për të rritur profilin e vet ndërkombëtar paralel me aktivitetet në nivel institucional, në bashkëpunim me partnerët, ka ftuar studiues dhe kërkues nga Universitetet e huaja për të rritur bashkëpunimin midis anëtarëve të Fakultetit. [Evd.82,83]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Në Rektorat funksionon një zyrë e posaçme e informimit për studentët dhe publikun në tërësi. Ndërsa në FM, ky proces kryhet fillimisht nga Sekretaria mësimore dhe mandej në varësi të informacionit të kërkuar, adresohet në strukturat e tjera të Fakultetit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma: format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve. Në Fakultetin e Mjekësisë nëpërmjet ekraneve të instaluar afishohen në mënyrë të vazhdueshme informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin akademik dhe njoftime të tjera të Fakultetit. Faqet zyrtare të UMT dhe FM pasurohen në mënyrë të vazhdueshme dhe publikojnë informacionet e nevojshme në përputhje me ligjin për




	<p>të drejtën për informim dhe Programin e transparencës që UMT zbaton.</p> <p>Për tu ardhur në ndihmë studentëve të rinj, FM çdo vit përditëson dhe publikon katalogun e studentit dhe hartën e mjediseve të cilat përmbajnë mjaft informacione të vlefshme për FM, programet, infrastrukturën, personelin akademik, jetën studentore dhe mjaft informacione të vlefshme për studentët dhe përfshirjen e tyre në jetën e fakultetit.</p> <p>Fakulteti ka funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor. <a href="http://umed.edu.al/">http://umed.edu.al/</a></p> <p>Gjithashtu, një burim i qenësishëm informacioni janë sekretarët e departamentit ku studenti merr asistencën e nevojshme në lidhje me organizimin e mësimit, lajmërimin për aktivitete të ndryshme, diplomimin, problematika në lidhje me procesin mësimor. [Evd.58]</p> <p>Sekretaria mësimore është një njësi ku studenti mund të marrë një seri shërbimesh, të cilat ofrohen të gjitha pa pagesë, informohet në lidhje me ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi. [Evd.109]</p> <p>Biblioteka e Fakultetit njëkohësisht vihet në dispozicion të studentëve dhe KSFM për informacione, konsultime, trajnime dhe këshillime për tematika të ndryshme.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës në Fakultet është një strukturë ku studentët mund të marrin informacion në lidhje me trajnimet, praktikat apo ofertat e punësimit. Procedurat për informimin dhe transparencën në informim janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse [Evd.88]. Kjo zyrë mirëpret, informon dhe orienton studentët në lidhje me aspekte të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Nga ana tjetër kjo zyrë merr përsipër të njoftojë dhe ndjekë studentët në lidhje me aktivitete me karakter shkencor apo trajnimi për përditësimin e njohurive të tyre. Zyra siguron mundësi të ndryshme trajnimi, mobiliteti, projektsh dhe bashkëpunon ngushtë me këshillat studentorë. [Evd.90]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Prej vitit akademik 2018 - 2019, aktivitetit të Zyrës së këshillimit të karrierës dhe personave të kontaktit në fakultete i bashkëngjitet edhe databaza e të diplomuarve nga zbatimi i projektit Gradua. Të dhënat e gjeneruara jo vetëm ndihmojnë studentët për punësim por më së shumti do ti shërbejnë UMT dhe Fakultetit të mbajë kontakte të vazhdueshme dhe të ndjekë historikun e punësimit të studentëve të diplomuar në vite. [Evd.96]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret 1-2, Standardi VI.1 përmbushen plotësisht, Në zbatim të ligjit ligjin për arsimin e lartë LAL 80/2015, neni 103, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), UMT implementon dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. [Evd.9-11]</p> <p>Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. [Evd.1]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Angazhimin institucional për krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, UMT e ka parashikuar edhe në Planin e zhvillimit strategjik 2017-2020 në të cilin parashikohet përgjegjësia institucionale për konsolidimin e cilësisë dhe mekanizmat me të cilat kjo do të arrihet. [Evd.4]</p> <p>Ne UMT, që me krijimin e tij funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evd.9] e cila harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional [Evd.10], në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kodin e cilësisë.</p> <p>NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore.</p> <p>Në zbatim të detyrimeve që lindin në përmbushje të standardeve dhe kriterëve të sigurimit të cilësisë dhe përcaktimeve të NJSBC në nivel institucional, Departamenti i Farmacisë bashkëpunon me FM e cila ka të përcaktuar personin përgjegjës i cili koordinon procesin e sigurimit të cilësisë në Fakultet dhe bashkërendon punën me NJSBC në nivel institucional. Një nga anëtarët e NJSBC i përket gjithashtu Departamentit të Farmacisë.</p> <p>Ndërkohë, për garantimin e cilësisë në nivel fakulteti, janë ngritur komisione ad-hoc, të cilat kanë kryer vlerësime dhe analiza tematike.</p> <p>Për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, FM nëpërmjet komisioneve ad-hoc, ka përdorur instrumentet standarde për mbledhjen e informacionit sikundër janë takimet dhe sondazhet me studentët. Komisioni ka përgatitur një set pyetjesh të cilat janë shpërndarë tek studentët për tu plotësuar në mënyrë anonime. Më pas janë analizuar të</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

	<p>dhënat dhe është finalizuar procesi. [Evd.97]</p> <p>Në nivel fakulteti, kryhet vlerësimi i performancës të personelit akademik në lidhje me ofrimin cilësor të programit të studimit, jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por dhe në aspektin e kërkimit shkencor, kontributit për institucionin.</p> <p>Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshëm bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës [Evd.80], plotësimi i së cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboreve, respektimi i orarit të mësimt, udhëheqjet për detyra kursi apo tema.</p> <p>diplome. Paralelisht edhe titullarët e lëndëve plotësojnë formularët e performancës për stafin me kohë të pjesshme që ata aktivizojnë në lëndët përkatëse i cili merret parasysh në procesin e rekrutimit të tyre në vitin akademik pasardhës. [Evd.78]</p> <p>Gjithashtu bëhet vlerësimi i aktivitetit shkencor të stafit pedagogjik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve orale në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Përgjegjësit e departamenteve vlerësojnë gjithashtu dhe aktivitetin administrativ të pedagogëve duke vlerësuar korrektesën në kryerjen e tyre, realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit.</p> <p>Plotësimi i performancës së stafit akademik i bëhet me dije Dekanit dhe depozitohet në Dekanat. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti paraprak i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit.</p> <p>Vlerësimi nga stafi akademik është mekanizëm nëpërmjet të cilit është synuar jo vetëm forcimi i kulturës së cilësisë në nivel institucional, por referuar raporteve analitike përkatëse [Evd.12]. NJSBC ka orientuar titullarët e institucionit e më tej dhe organet kolegjiale, për përmirësimin e praktikave dhe procedurave administrative me qëllim objektivin për rritjen e motivimit të personelit akademik.</p> <p>Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel departamenti/fakulteti/universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë. [Evd.84,85].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL.</p> <p>Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në 2017, realizoi për të parën herë procesin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional nga QAA dhe ASCAL, dhe është akredituar me një nga vlerësimet më pozitive në institucionet publike për një periudhë 5 vjeçare [Evd.15]. Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm institucional i UMT, kanë qenë</p>





	pjesë e diskutimeve, e adresimit të problematikave dhe vetë rregullimit dhe në dokumentet themelore të UMT dhe të njëjve përbërëse të tij [Evd.22,154,155]. Arritja e këtij rezultati tregon se UMT dhe njësitë përbërëse, ndjekin dhe zbatojnë politika të qarta për sigurimin e cilësisë.		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron UMT, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC [Evd.11] dhe në aktet rregullative të institucionit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.	GVJ konstaton se standardi VI.2 përmbushet plotësisht. Koordinator i programit të studimit [Evd.66] është personi përgjegjës i cili ndjek dhe monitoron ecurinë e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në Departamente dhe Dekanat, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.	Ndërkohë, në analizën vjetore të njëjve bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre. [Evd.85]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Pjesë të kësaj analize janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmblytur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim. [Evd.45]
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, në përfundim të çdo viti akademik, Drejtorja e Kurrikulave nis procesin e përditësimit të programeve në nivel institucional me qëllim rritjen e cilësisë në përmbajtje të tyre. [Evd.47]
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në	Për vitin akademik 2018 – 2019, programi u përditësua në zbatim të VKM 41, si dhe janë rishikuar syllabuset e lëndëve në elementë të caktuar (literaturë, tema etj.). Gjithashtu edhe për këtë vit akademik (2019-2020) është bërë rishikimi i programeve, kryesisht në syllabuse





vijim të cilësisë	<p>në skemën e vlerësimit [Evd.164]. Në përfundim të procedurave të ndjekura në funksion të përditësimit/rishikimit apo përmirësimit të programit, iu përcillet autoriteteve vendimmarrëse për programin (Përgjegjës Departamenti / Dekan) si dhe organeve kolegjiale (Dekanati dhe Senati Akademik), sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Të gjitha rezultatet e mësipërme janë pjesë e analizave vjetore të njësisive bazë dhe kryesore të UMT. Në raportin vjetor në nivel universiteti, NJSBC, si strukturë përgjegjëse, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin. Ky raport është subjekt i diskutimeve në mbledhjen e organeve kolegjiale të UMT (Senat Akademik dhe Bordi i Administrimit), ku evidentohet qartë plani i masave me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit. <a href="http://umed.edu.al/">http://umed.edu.al/</a></p> <p>NJSBC në nivel institucional dhe në fakultete, ka kryer trajnime dhe diskutime të vazhdueshme me përfaqësues të fakultetit, kjo falë dhe procesit të akreditimit institucional që përfundoi UMT-ja. Në vitin akademik 2018 – 2019, ishte parashikuar zhvillimi i sondazheve on-line me studentët e fakulteteve për monitorimin e mësimdhënies dhe performancës së personelit akademik. Për këtë qëllim FM, draftoi pyetëSORIN për shpërndarjen tek studentët nëpërmjet platformës ESSE3, por si rezultat i zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS) nga ASCAL ky proces u ndërpre. <a href="https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve">https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve</a>].</p> <p>Në këtë proces, NJSBC, fakultetet e UMT janë angazhuar maksimalisht për realizimin me suksese të këtij procesi. Institucioni dhe Fakulteti i Mjekësisë është në pritje të rezultateve nga ky proces dhe në varësi të tyre do të analizojë dhe adresojë për zgjidhje problematikat e vërejtura. Me miratimin e statutit të ri [Evd.1], procesi i sigurimit të brendshëm të cilësisë do të ketë një organizim të ri me fokus zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të cilësisë nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe sistemeve të automatizuara të vlerësimit të performancës. [Evd.6].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi VI.3**

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e	Vlerësimi i programit të studimit në kuadër të akreditimit kryhet për herë të parë. Ndërkohë, vlerësime për cilësinë e ofrimit të tij janë



<p>cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>kryer në mënyrë të vazhdueshme nga FM. Rishikimi periodik i programit dhe përditësimet e tij, janë pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të tij prej vitesh. Këto procese kryhen në bashkëpunim me NJSBC dhe në përputhje me procedurat, aktet rregullatorë të UMT dhe rregullores së NJSBC. [Evd.46]. Të gjitha këto rezultate të vlerësimit, përfshihen në raportet vjetore të njëjste kryesore dhe të institucionit, si dhe në raporte të vlerësimit të brendshëm institucional të kryer në kuadër të akreditimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Metodat e vlerësimit të cilësisë bazohen në mekanizma kryesore të matjes në bazë të të cilave kryhet vlerësimi i cilësisë të programit të studimit, që janë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitorimi nga NJSBC në nivel institucional</li> <li>- Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit të studimit</li> <li>- Vlerësime nga komisione ad-hoc të ngritura nga Dekani i Fakultetit. Realizim sondazhesh dhe mbledhje informacionesh nga studentët [Evd.7].</li> <li>- Monitorime nga drejtuesit e Departamentit</li> <li>- Monitorime nga zyra e burimeve njerëzore dhe sekretaria mesimore</li> </ul> <p>Ndërkohë takimet me studentët, takime me këshillin studentor janë proces i vazhdueshëm që realizohet nga Dekani i Fakultetit; në shumicën e rasteve raportimet e tyre, apo pjesëmarrja e këshillit studentor në mbledhjet e dekanatit, shpesh janë pikënisja e një procesi të caktuar monitorimi / vlerësimi [Evd.122].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Një nga procedurat e ndjekura në vitet e fundit në kuadër të përmirësimit të cilësisë si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet e provimeve apo detyrave të studentëve realizohet nga takimet e drejtpërdrejta me studentë të diplomuar gjatë edukimit në vazhdim pasi Departamenti është pjesë e ofrimit të edukimit në vazhdim por edhe pjesë e provimit të praktikës profesionale pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë si dhe pjesë e komisionit të provimit të shtetit pranë QSHA. Duke qenë i përfshirë edhe në zinxhirin e licensimit dhe tregut të punës ka mundësi të marrë edhe mendimet dhe sugjerimet e studentëve të diplomuar. Bashkëjetesa në rrjetin farmaceutik të personelit akademik me studentët tashmë të punësuar ose me praktikantët gjatë realizimit të praktikës profesionale, bën të mundur që të tërhiqen mendimet e tyre tashmë në nivel kolegësh. [Evd.96].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e</p>	



programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që institucioni ka të parashikuar, janë përgjegjëse të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të UMT. [Evd.3].</p> <p>Në të gjitha këto akte, synimi kryesor është gjithpërfshirja ku të gjithë kontribuesit në procesin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera akademike, të ndihen të përfshirë. Për më tepër kur në rastin konkret përgjegjës për ofrimin e programit të studimit është departamenti. Sikundër është përshkruar në standardin VI.3 më lart, të gjithë mekanizmat e parashikuar në kuadër të sigurimit të cilësisë së programit të studimit, janë gjithëpërfshirës. [Evd.66].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregulloret e UMT dhe të Fakultetit kanë të përcaktuar qartë jo vetëm rolet por dhe përgjegjësitë e çdo njësie/strukture dhe individit të angazhuar në ofrimin e programit të studimit dhe garantimin e cilësisë së tij.</p> <p>Aspekte si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Evidentimi dhe ndjekja e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>- Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.</li> <li>- Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti.</li> <li>- Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi.</li> <li>- Orientimi dhe udhëheqja metodike e procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete.</li> <li>- Vlerësimi i performancës së stafit akademik. Në planin e masave të publikuar nga NJSBC</li> <li>- Zbatimi i detyrave të lëna nga grupe të jashtme vlerësimi, auditimi dhe hartimi i planit të masave</li> </ul>



	janë disa nga elementët kyç që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, kontrollin e vazhdueshëm të saj gjatë zhvillimit të programit të studimit që aplikojnë njësitë përgjegjëse sipas fushës së veprimtarisë në FM.			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Mekanizmat e parashikuar në kuadër të sigurimit të cilësisë së programit të studimit, janë gjithëpërfshirës. Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë dhe ofrimit të programit të studimit është proces dinamik dhe në zhvillim në Departamentin e Farmacisë [Evd.89,95,98].			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. Politikë e proceseve të vlerësimit ndjekur nga NJSBC dhe fakulteti ka ndikuar në krijimin e një fryme besimi, shmangien e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve dhe mbi të gjitha krijimin e një kulture përgjegjshmërie dhe përgjegjësie lidhur me rolin e gjithsecilit në mbarëvajtjen e programit të studimit. [Evd.12].			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	UMT përveç gjithëpërfshirjes së stafit dhe studentëve në procese të ndryshme të cilësisë, ka në filozofinë e vet transparencën dhe informimin në lidhje me proceset që kryhen. Si rregull çdo procedurë që kryhet kalon nëpërmjet njoftimit paraprak dhe më pas kalon në proces zhvillimi [Evd.133]. Në këto procese vazhdimisht përfshihen bashkëpunëtorë, partnerë ose dhe studentë të diplomuar, të cilët ndihen pjesë integrale e çdo procesi me rëndësi në fakultet.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike në faqen zyrtare të UMT, fton studentët dhe personelin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet. [Evd.6].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Pjesë e këtij procesi nuk është vetëm publikimi i procedurave apo njoftimeve periodike por edhe publikimi i rezultateve, raporteve nga procese të zhvilluara. Raportet vjetore, vendimet e organeve kolegjiale, raportimet periodike të Rektoratit që lidhen me procesin mësimor dhe sigurimit të cilësisë së mësimdhënies, janë proces i vazhdueshëm. [ <a href="http://umed.edu.al/">http://umed.edu.al/</a> ].




<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Të njëjtin proces raportimi dhe publikimi të rezultateve ndjek dhe FM dhe e bën publike në faqen zyrtare të fakultetit [<a href="https://www.fakultetimjekesise.edu.al/">https://www.fakultetimjekesise.edu.al/</a>]</p> <p>Përveç informimit dhe publikimit të rezultateve që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, një aspekt mjaft i rëndësishëm është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse.</p> <p>Nëse këto gjetje kanë impakt në organizimin e institucionit dhe prekin aspekte të rëndësishme të funksionimit të tij, ato diskutohen në Senatin Akademik. Në rastet kur gjetjet kanë impakt financiar ato adresohen për vlerësim dhe vendimmarrje në Bordin e Administrimit. <b>[Evd.45]</b>.</p> <p>Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna.</p> <p>P.sh. në kuadër të akreditimit institucional të UMT, iu la detyrë nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë për mësimdhënien si për stafin e ri akademik, ashtu dhe për stafin me eksperiencë.</p> <p>Në këtë kontekst, nga UMT u hartua një plan veprimi konkret me objektiva të qarta për tu realizuar.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi nga departamentet të nevojave të stafit akademik për përmirësimin e cilësisë.</li> <li>2. Identifikimi i universiteteve partnere në kuadër të programit Erasmus+, për shkëmbimin e stafit akademik të UMT-së, me qëllim dhe përfitimin e metodave të reja të mësimdhënies.</li> <li>3. Hartimi dhe realizimi i projektit të dedikuar për ngritjen e qendrës së simulimit klinik e cila ofron mundësi trajnimi për stafet akademike, si dhe eksperimentim gjatë procesit mësimor, gjë që ndikon direkt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik dhe mësimnxënies për lëndët anatomi, semiologji imazherike dhe klinike.</li> <li>4. Nxitja e personelit akademik për pjesëmarrje në projekte në kuadër të bashkëpunimeve me universitete në vendet e BE, duke përfshirë staf të ri akademik dhe mundësisht studentë, ku një ndër objektivat e projekteve të orientohet drejt mësimdhënies bashkëkohore.</li> <li>5. Futja e platformave online (moodle)</li> <li>6. Identifikimi i ekspertëve për mësimdhënien në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, hartimi i axhendës së aktiviteteve/trajnimeve me objektiv rritjen e cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik të UMT-së</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të personelit akademik, administrativ dhe studentët. Për të rritur këtë impakt dhe për të rritur kulturën e vetë ndërgjegjësimi, NJSBC dhe</p>



vijim të cilësisë së programit të studimit.	përfaqësuesi në FM vazhdimisht organizon takime me strukturat e fakultetit për të rritur efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të saj.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. [Evd.120].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Integruar në “Farmaci” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. **Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programit të studimit.** Posaçërisht marrëveshjet dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit, duke përfshirë edhe universitete në nivel ndërkombëtar. Kjo e fundit ka pasur impakt pozitiv në aktivitetin e kerkimeve shkencore.
2. **Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit,** Posaçërisht reflektimi i kërkesave të strukturave të rregullimit të profesionit dhe tregut profesional në kurrikulën e studimit si dhe bashkpunimi me këto struktura. Kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
3. Mekanizmat dhe aktivitetet rreth **mbështetjes së studenteve.** Këto janë evidentuar qartë si dhe studentet kanë lënë përshtypje tek GVJ se ndihen jashtzakonisht të suportuar. Poashtu politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit janë pika të forta. Cilësia hyrëse dhe dalëse e studentëve të këtij programi studimi.

**Pika për përmirësim në të ardhmen:**

1. Publikimi/përditësimi në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë i informacioneve relevante që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme.
2. Cilësia e pjesëmarrjes në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare.
3. Financimi për kërkimin shkencor.
4. Politika dhe aktivitetet për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

**Rekomandime**

1. Edhe pse faqa Ëeb është e pasur me publikimi të aktiviteteve, GVJ rekomandon që të pasurohet edhe ajo në gjuhën angleze (me i informacioneve që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme).
2. Të rritet cilësia e pjesëmarrjes në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare. Të targetohen konferencat kyçe.
3. Të shikohet mundësia e përfitimit të fondeve ose granteve për kërkimin shkencor.
4. Të rishikohen politika dhe aktivitetet rreth pronësisë intelektuale dhe ky aktivitet të inkurajohet duke vendosur sisteme/procedura përkatëse dhe trajnim të stafit akademik.




## Conclusions of the evaluation of the second cycle study program Master of s in "Pharmacy" of "University of Medicine, Tirana"

### Strong points and affirmations

1. **Delivery, organization and orientation of the integrated study programme.** Specifically, relationships, agreements and collaborations with other institutions, companies, third parties, home and foreign businesses within the framework of professional vocational training, research and mobility, including universities at an international level. The latter has had a positive impact on research activity.
2. **Structure and content of the study programme.** Specifically, reflection of the requirements of structures that regulate the profession and labour market within the curriculum, as well as collaboration with these structures. Qualifications of academic staff involved in the programme of study.
3. Mechanisms and activities in place related to **student support.** These have been evidenced clearly and students left an impression on the external evaluation group that they felt very supported. Additionally, policies and procedures around admission, selection, progress, transfer, recognition, assessment of knowledge and graduation in the study programme are strong points. Together with the quality and profile of students at entry into, and exit from, the study programme.

### Points for future improvement

1. Publication/updates on the website of information relevant to the study programme, academic staff and different activities in at least two languages
2. Quality of international conferences/symposia/activities in which academic staff participate
3. Research funding
4. Policies and activities related to intellectual property.

### Recommendations:

1. Although the institution's web site is populated with up to date information around the programme of study, academic staff and different activities, the external evaluation group recommends that this is also done in English.
2. To consider improving the quality of participation in international activities (including conferences). The ambition should be to target key international conferences to raise the international profile of the institution.
3. To place more focus on considering different opportunities around research funding.
4. To review policies and activities related to intellectual property and encourage this activity via establishing systems in place and training of academic staff.






## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X